



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 59 Akti

Nr. 87 Vendimi
Tiranë, më 17.12.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Brunilda Bekteshi	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra, më datë 14 dhjetor 2018, ora 11:30, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, salla B, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Fatos A. Qato, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, përfaqësuar personalisht dhe me avokat, z. Julian Mërtiri, me deklaram në seancë.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b, paragrafi 5 dhe nenet Ç, paragrafi 1, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.**
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Fatos Qato, me funksion gjyqtarë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, referuar pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
2. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, z. Fatos Qato, ka qenë kandidat për anëtar të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, në bazë të pikës 9 të nenit 284, sipas ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në këto kushte iu nënshtrua procedurave të rivlerësimit me përparësi.
3. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
4. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 24.01.2018, të trupit gjykues nr. 3, pas studimit të raporteve të vlerësimit të sipërpërmendura, e hartuar nga institucionet shtetërore, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 për të tri kriteret, bazuar në pikën 1 të nenit 4 të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës si dhe vlerësimin e aftësisë profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesuesi i trupit gjykues, znj. Valbona Sanxhaktari. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
5. Komisioni filloi hetimin administrativ për të tri kriteret e vlerësimit dhe vazhdoi hetim të thellë dhe të gjithanshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë. Gjatë këtij hetimi, trupi gjykues pasi vlerësoi se është hetuar në mënyrë të plotë kriteri i pasurisë, bazuar në provat e grumbulluara dhe vlerën e tyre provuese, vendosi që hetimi administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Fatos Qato, të përfundojë vetëm për këtë kriter, pa qenë nevoja e përfundimit të hetimit të plotë edhe të dy kriterëve të tjera, në përputhje me nenin 4, pika 2, e ligjit nr. 84/2016.
6. Më datë 09.02.2018, subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues, për të cilën po në këtë datë deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
7. Më datë 15.11.2018, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 2 vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Fatos Qato, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes, vetëm për kriterin e pasurisë.
8. Më datë 19.11.2018, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të paraqesë pretendime/sqarime shtesë, brenda 12 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

9. Më datë 28.11.2018 Subjekti i rivlerësimit kërkoi zgjatje të afatit të procedurës për paraqitjen e shpjegimeve apo provave në lidhje me rezultatet e hetimit për një kohë prej 12 ditësh, kërkesë e cila iu pranua, duke i dhënë subjektit dhe 3 ditë shtesë, në një afat total prej 15 ditësh.
10. Më datë 06.12.2018, subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet e tij, mbi rezultatet e hetimit kryesisht.
11. Më datë 12.12.2018, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 3, vendosi të ftoj subjektin e rivlerësimit, z. Fatos Qato, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej, më datë 14.12.2018, ora 11:30, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, salla B, Tiranë.
12. Më datë 14.12.2018, u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent.
13. Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, në bazë të të cilit: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.”*, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Fatos Qato, vetëm mbi komponentin e vlerësimit të pasurisë.
14. Ky vendim mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit për z. Fatos Qato merret vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kjo nuk përbën gjë të gjykuar (*res judicata*) për kriterin e vlerësimit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Fatos Qato, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, z. Fatos Qato, iu përgjigj pyetjeve të drejtuara, nga anëtarët e trupit gjykues dhe vëzhguesi ndërkombëtar, shprehu qëndrimin e tij, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Fatos Qato, kërkoi konfirmimin në detyrë.

Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Fatos Qato. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 14.12.2018, për të rifilluar më datë 17.12.2018 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Fatos Qato, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke ofruar informacion kur i është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij, por ndërkohë komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka deklaruar qartazi kërkesat e komisionit.

Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja:

Deklarimi i subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur është dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 27.01.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. ILDKPKI-ja ka dërguar raportin e detajuar nr. 539/30 prot., datë 08.01.2018, lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ku konstatohet se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; (c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, datë 06.12.2018, dhe deklaratimeve të subjektit gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit. Nga shqyrtimi i provave të administruara nga Komisioni, për secilin nga asetet dhe të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, rezultojnë se:

Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën “Vetting”, sipas formularit (Shtojca 2), të datës 27.01.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

1. Për deklarinin në lidhje me apartamentin, me sip. 141 m², ndodhur në, Rr. “ *** ”, pll. ***, ap. ***, regjistruar në regjistrin hipotekor, pasuri me nr. ***, vol. ***, fq. ***, ZK ***. Apartamenti i është blerë shoqërisë “****” sh.p.k., me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.01.2017, në vijim të kontratës së porosisë individuale e datës 05.02.1997, me palë blerëse, Fatos e M. Qato, vlera e asetit 28.200 USD. Pjesa takuese: 50%. **Me burim krijimi të deklaruar:** i) kursimet e familjes ndër vite.

1.1 Për këtë aset subjekti ka paraqitur:

1.1.1 Kontratë porosie individuale, më datës 05.02.1997, me porositës Fatos Qato dhe të porositur shoqëria “****” sh.p.k. vlera **28.200 USD**, e vërtetuar me vërtetim nr. *** rep., datë. 07.02.1997, të noterit A. Gj. Në kontratë në lidhje me mënyrën e pagesës është parashikuar se: “Shuma prej 28.200 USD do të paguhet si më poshtë: Kësti i parë, më datë 20.01.1997, në shumën **846.000** lekë, kësti i dytë me arritjen e punimeve në katin e IV në shumën **8.460 USD**, me fillimin e punimeve të rifiniturës, porositësi duhet të derdhë në llogarinë e të porositurin shumën **8.460 USD** (kësti i tretë), vlera prej 10 % ose 2.820 USD do të likuidohet kur të dorëzohet objekti

përfundimisht”.

1.1.2 Aneks kontrate, me palë, z. Fatos Qato dhe të porositur, shoqëria “****” sh.p.k., vlera e apartamentit 28.200 USD.

1.1.3 Kartelë pasurie me të dhëna: ZK ***, nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, apartament, me sip. 141 m², në bashkëpronësi Fatos dhe M. Qato, data e regjistrimit 27.01.2017.

1.2 Faktet dhe rezultuara nga hetimi administrativ:

1.2.1 Në deklaratën “Vetting” deklarohet, apartament me sip. 141 m², ndodhur në, Rr. “ *** ”, pll. ***, ap. ***, me pjesë takuese të subjektit 50 %, fituar me kontratën e porosisë individuale, datë 05.02.1997, në vlerë 28.200 USD.

1.2.2 Burimet e krijimit të deklaruara për këtë pasuri në deklaratën “Vetting” janë: kursimet e familjes ndër vite.

1.2.3 Rezulton se sipërmarrësi, shoqëria “****” sh.p.k., ka nënshkruar një kontratë sipërmarrje, më datë **05.02.1997**, me palë investitorë, Gjykatën e Apelit Tiranë e përfaqësuar në atë kohë, nga subjekti i rivlerësimit. Investitori kishte ngarkuar sipërmarrësin për ndërtimin e një godine 6-katëshe, me 18 apartamente në vlerën totale prej 434.000 USD, në Rr. “****”, kundrejt një çmimi të përcaktuar dhe në preventivin e punimeve, brenda një afati 15 muaj, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës. Në këtë godinë 6-katëshe, ndodhur në, Rr. “****”, subjekti i rivlerësimit kishte porositur apartamentin e tij me sip.141 m².

1.2.4 Regjistrimi pranë ZVRPP-së Tiranë i gjithë godinës dhe i apartamenteve, është kryer në bazë të një vendimi nr. ***, datë 14.11.1997, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, për vërtetimin e faktit juridik të ndërtimit të pallatit nr. ***, ndodhur në, Rr. “****”, me *** kate, me 21 apartamente midis së cilave dhe pasuria e subjektit. Për apartamentin e tij, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar kontratë porosie individuale, më datë 05.02.1997, kundrejt çmimit 28.200 USD.

1.2.5 Çmimi kontraktor, në vlerën prej 28.200 USD, dhe likuidimi i pagesave sipas të gjitha kushteve të përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes rezulton i parashikuar edhe në kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme të nënshkruar, më datë 25.01.2017, ku palët kanë deklaruar se nuk i detyrohen financiarisht njëri-tjetrit dhe se çmimi kontraktor quhej i likuiduar.

1.2.6 Mbi arsyet e kalimit të pronësisë së pasurisë apartament, në një afat kohor pas 20 vitesh, subjekti i rivlerësimit deklaroi pranë Komisionit se, kontrata e porosisë me investitor shoqërinë “****” sh.p.k., ishte hartuar në vitin 1997, menjëherë pas miratimit të lejes së ndërtimit nga organet kompetente dhe regjistrimi i pasurisë pallat ishte kryer në vitin 2014. Në vijim ka deklaruar se nga koha e regjistrimit të “objektit” në zyrën e regjistrimit dhe deri në regjistrimin e kontratës përfundimtare të shitjes, kishin pasur mosmarrveshje me shoqërinë ndërtuese lidhur me moskryerjen e disa punimeve jo në cilësinë e duhur dhe duke mos zbatuar parashikimet ligjore për të cilat kishin rënë dakord sipas marrëveshjes se bërë dhe kontratës së porosisë.

1.2.7 Sipas kontratës së porosisë individuale, më datë **05.02.1997**, pagesat kundrejt çmimit 28.200 USD, do të derdreshin në llogarinë e të porositurit në katër këste:

- Kësti i parë, më datë **20.01.1997**, që i përket 30 % të çmimit, në shumën 846.000 lekë.
- Kësti i dytë, me arritjen e punimeve në katin e katërt, do paguhet shuma 8.460 USD.
- Me fillimin e punimeve të rifiniturës porositësi duhet të derdhë 30 % të vlerës së përgjithshme, në shumën prej 8.460 USD.
- Vlera prej 10% në shumën 2.820 USD, e mbetur nga shuma totale e preventivuar do të likuidohet kur të dorëzohej objekti përfundimisht me çelësa në dorë.

1.2.8 Lidhur me mënyrën dhe dokumentimin e pagesave të çmimit kontraktor, të apartamentit sipas termave të kontratës, subjekti i rivlerësimit, deklaroi se pagesat e vlerës së apartamentit sipas kontratës së porosisë me vlerë 28.200 USD, ishin bërë me këste, kurse lidhur me dokumentacionin, dispononte vetëm mandatarkëtim për këstin e parë dhe të dytë (janar - dhjetor 2007), konkretisht;

- ✓ Mandatarkëtim nr. ***, datë 15.01.1997, kësti i parë në vlerën 846.000 lekë;
- ✓ Mandatarkëtim nr. ***, datë 08.12.1997, kësti i dytë në vlerën 8.460 USD.

Lidhur me këstin e tretë dhe të katërt subjekti i rivlerësimit deklaroi se:

- ✓ Kësti i tretë ishte likuiduar por nuk dispononte mandatarkëtim, pasi e kishte humbur, gjithashtu dhe likuidimin e këstit të katërt prej 10 % të vlerës nuk e dispononte.

1.2.9 Lidhur me burimin e ligjshëm të përdorur për blerjen e apartamentit, subjekti deklaroi gjatë hetimit administrativ se: “Burimet e përdorura për blerjen e apartamentit ishin të ardhurat nga pagat dhe kursimet familjare si dhe ndihmesë nga prindërit e bashkëshortes që bashkëjetojnë me të, duke theksuar se në atë periudhë prindërit e bashkëshortes kishin lëshuar me qira vilën, ndodhur në, Rr. “****”, nr. ***, fondacionit gjerman “****”.

1.2.10 Mbi këtë deklaram të subjektit gjatë hetimit administrativ për burimin e ligjshëm, Komisioni, ka konstatuar se në deklaramet periodike, dhe në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar si burime **të ardhurat/kursimet e familjes në vite**. Nuk rezultonte që në këto deklarime të ishte deklaruar se për blerjen e kësaj pasurie, kishin shërbyer si burim krijimi edhe të ardhurat e prindërve të bashkëshortes. Gjithashtu subjekti nuk depozitoi dokumentacion për të provuar të ardhurat e përfituar nga prindërit e bashkëshortes për shkak të dhënies së vilës me qira fondacionit gjerman “****”.

1.2.11 Në vijim, për të vlerësuar nëse subjekti i rivlerësimit kishte burime të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, Komisioni, kreu analizën financiare bazuar në deklaratën “Vetting”, e atë periodike, si dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga ana e tij, vetëm mbi pagesat e dokumentuara **për dy këstet**¹ e çmimit kontraktor.

¹ Për transaksionin e kryer, më datë 08.12.1997, paguar shuma 8.460 USD, e konvertuar 151.98 lekë/USD, sipas kursit të këmbimit, më datë 08.12.1997, marrë nga Banka e Shqipërisë, shuma 1.285.750 lekë, plus 846.000, gjithsej shuma 2.131.751 lekë ,paguar deri në fund të vitit 1997.

1.2.12 Lidhur me përllogaritjet e kryera, Komisioni, konstatoi se subjekti nuk kishte depozituar dokumentacion për pagat e përfituara nga puna e tij për periudhat 21.03.1983 - 01.04.1993, dhe të bashkëshortes, për periudhën shtator 1990 - prill 1995, pasi në institucionet ku kishte punuar, subjekti deklaroi se nuk dispononte dokumentacion, si dhe nga ana e tij nuk u deklaruan shumat përkatëse edhe në nivel deklarativ pas kërkesës së Komisionit.

1.2.13 Për të kryer analizën financiare, Komisioni, në pamundësi për të siguruar dokumentacion lidhur me:

- ✓ të ardhurat e subjektit për vitet 1983 - 1993², si dhe në mungesë të deklarimit të shumave konkrete nga ana e subjektit, mori për analogji të ardhurat për të njëjtën periudhë të një subjekti tjetër rivlerësimi, i cili për këtë periudhë kishte mbajtur të njëjtin funksion si subjekti i rivlerësimit, z. Fatos Qato, dhe kishte dokumentacion provues për pagesat e marra.
- ✓ të ardhurat e bashkëshortes, për periudhën shtator 1990 - prill 1995, mori për referencë të ardhurat e subjektit po në këto vite, ndërsa për periudhën shtator 1996 - dhjetor 1997, u morën për referencë të ardhurat e dokumentuara prej bashkëshortes së subjektit në vitin paraardhës ose pasardhës.

1.2.14 Lidhur me shpenzimet për jetesë që subjekti kishte pasur, për periudhën nga dhjetori 1986 deri në dhjetor 1997, pas deklarimit të tij, më datë 27.09.2018, pranë Komisionit se shpenzimet kanë qenë minimale³, Komisioni, kreu llogaritjet duke mos i zbritur shpenzimet jetike për periudhën 1983 - 1997.

1.2.15 Nga analiza financiare e kryer, sipas tabelës nr.1, Komisioni, konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kishin pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e apartamentit (pagesën e dy kësteve) në vitin 1997, në vlerën **-266.787 lekë**, edhe pse në analizën financiare nuk u zbritën shpenzimet jetike për periudhën 1983 - 1997.

Tabela nr. 1

Analizë financiare 1983 – 1997	
Të ardhura subjekti, 21.03.1983 – 1997	1,300,793
Të ardhura bashkëshortja, 1990 – 1997	564,171
Totali i të ardhurave	1,864,964
Shpenzime për blerjen e apartamentit	-2,131,751
Diferenca e pajustificuar	-266.787

1.2.16 Nga analiza e fakteve të sipërpërmendura, Komisionit i rezultoi, dhe për pasojë i kaloi barrën e provës, pasi dukej se:

- a) subjekti nuk kishte deklaruar saktë datën/muajin/vitin se kur ishin paguar 2 këstet e tjera për blerjen e apartamentit, me sip. 141 m², si dhe nuk provoi me dokumentacion këto pagesa;

² Nëpërmjet 2 pyetësorëve në lidhje me të ardhurat e gjeneruara nga puna e subjektit dhe e bashkëshortes, subjekti ka deklaruar se për periudhat 1983 - 1993, nuk disponon dokumentacion si dhe nuk deklaroi shuma konkrete se sa ka qenë paga.

³ Subjekti ka deklaruar se shpenzimet kanë qenë minimale kryesisht për periudhën 1986 - 1990, sepse në atë periudhë ka qenë beqar si dhe nuk ka pasur shpenzime akomodimi. Për vitet 1991 - 1997, subjekti ka deklaruar se shpenzimet kanë qenë të pakta sepse fëmijët kanë qenë të vegjël dhe nuk ka pasur shpenzime për akomodim, etj, sepse ka banuar te shtëpia e prindërve të bashkëshortes.

b) bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion dukej se kishte mungesë të burimeve financiare, për të justifikuar blerjen e apartamentit, si dhe për të përballuar shpenzimet jetike.

1.3 Komisioni, për vërtetimin e fakteve dhe burimit të të ardhurave, administroi nga institucionet publike dhe private, si dhe mori deklarime të vetë subjektit me anë të postës elektronike, si më poshtë:

1.3.1 Shkresën nr. * prot., datë 22.02.2018,** ZVRPP-së Tiranë, përmes së cilës Komisioni u informua mbi kontratën e sipërmarrjes, lidhur më datë **05.02.1997**, ndërmjet palëve: Gjykatës së Apelit Tiranë, në cilësinë e investitorit, përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit dhe shoqërisë ndërtimore “***” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, për ndërtimin e një godine 6-katëshe, në Rr. “***”, ku sipërmarrësi angazhohej që godinën e porositur nga investitori, ta ndërtonte brenda një afati 15 muaj, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

1.3.2 Shkresën nr. * prot, datë 22.02.2018,** përmes së cilës, **ZQRPP-ja Tiranë⁴**, konfirmon se në regjistrin e pasurive të paluajtshme rezulton në emër të Fatos dhe M. Qato, pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, ZK ***, lloji i pasurisë apartament, me sip. 141 m², shoqëruar praktika edhe me kontratën e porosisë individuale, më datë 05.02.1997, si dhe kontratën e shitjes, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.01.2017, me palë shitëse: “***” sh.p.k., dhe palë blerëse: Fatos e M. Qato.

1.3.3 Shkresën nr. * prot., datë 20.02.2018, të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike,** e cila konfirmon se referuar sistemit të faturimit në emër të z. Fatos Qato, identifikohet: kontrata e furnizimit me energji me nr. ***, në instancën e Tiranës, Blv. “***”, me datë hapje 18.08.2000.

1.3.4 Shkresën nr. * prot., datë 14.02.2018, të Ujësjetës Kanalizime Tiranë,** me anë të së cilës Komisioni informohet se në bazë të të dhënave të sistemit, në emër të z. Fatos Qato, figuron kontrata me nr. ***, për objektin me adresë, Rr. “***”, pll. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë, në kategorinë konsumatorë familjarë.

1.3.5 Për dokumentimin e të ardhurave është administruar:

- ✓ Vërtetim nr. *** prot., datë 09.11.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në lidhje me të ardhurat neto nga paga, për periudhën 31.03.1983 - 29.04.1984, ku shpjegohet se Arkiva e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, nuk disponon dokumentacion mbi të ardhurat e subjektit.
- ✓ Vërtetim, datë 24.01.2017, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për periudhën dhjetor 1986 - qershor 1992, ku informohet se nga ana e këtij institucioni nuk disponohet dokumentacion mbi të ardhurat e subjektit gjatë kohës që kishte punuar si hetues në Hetuesinë e Tiranës.
- ✓ Vërtetim nr. *** prot., datë 23.01.2017, i Gjykatës së Apelit Tiranë, në lidhje me të ardhurat neto nga paga, për periudhën 01.04.1993 e në vijim, ka dhënë informacion mbi të ardhurat e subjektit.

⁴ Në dosjen e subjektit ndodhen shkresat e Komisionit, me nr. *** prot, datë 05.02.2018, drejtuar ZQRPP-ve, më të cilën është kërkuar informacion mbi pasuritë e regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

- ✓ Vërtetim nr. *** prot., datë 25.10.2016, i Shkollës së Magjistraturës me të cilën jepet informacion në lidhje me të ardhurat e realizuara nga subjekti nga puna në këtë institucion për periudhën 1999 - 2001.
- ✓ Shkresë e Arkivit Qendror të Shtetit, nr. *** , datë 15.12.2016, në të cilën pasqyrohen të ardhurat në vite për subjektin e rivlerësimit me iniciale G. D, e përdorur si referencë për llogaritjen e të ardhurave të përfituar nga subjekti.
- ✓ Shkresë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, nr. *** prot., datë 08.02.2018, me anë të së cilës jepen të dhëna në lidhje me të ardhurat financiare bruto dhe neto të realizuar nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja.
- ✓ Shkresë nr. *** prot., datë 25.01.2019, nga Bashkia Tiranë, me të cilën vërtetohet punësimi i zj. M. Q., për periudhën shtator 1990 - prill 1995, por nuk jepen të dhëna mbi të ardhurat e përfituara.
- ✓ Vërtetim nga Bashkia Tiranë, nr. *** prot., datë 20.01.2017, për zj. M. Sh., në të cilin jepen të dhëna për të ardhurat e përfituara, për periudhën gusht 1995 - shtator 1996.
- ✓ Vërtetim *** prot., datë 26.10.2016, i ZQRPP-së Tiranë me të cilin jepet informacion në lidhje me të ardhurat e realizuara nga zj. M. Q. nga puna në këtë institucion, për periudhat: maj 1997 - 30 gusht 2007 dhe për periudhën 04.11.2013 e në vijim.
- ✓ Vërtetim, datë 20.01.2017, i Kolegjit Universitar “***”, për të ardhurat e realizuara nga punësimi i zj. M. Q., pranë këtij institucioni, për periudhat 01.01.2006 - 031.12.2006; dhe 01.01.2007 - 31.12.2007.
- ✓ Vërtetim nr. *** prot., datë 25.11.2016, i përmbauesit gjyqësor privat A. S., me anë të së cilit vërtetohet ekzekutimi i vendimit gjyqësor, nr. *** , datë 19.06.2008, nëpërmjet të cilit znj. M. Q., ka përfituar shumën 1.822.531 lekë.
- ✓ Vërtetim nr. *** prot., datë 13.01.2017, i Shkollës së Magjistraturës me të cilin jepet informacion në lidhje me të ardhurat e realizuara nga znj. M. Q., nga puna në këtë institucion, për periudhat 2005 - 2008, 2010 - 2012 dhe vitet 2014 dhe 2015.

1.4 Subjekti i rivlerësimit, me anë të shpjegimeve dhe provave të depozituara, më datë 06.12.2018, si dhe deklarimeve në seancën dëgjimore ka argumentuar se:

1.4.1 Në lidhje me faktin se nuk provoi me dokumentacion pagesën për këstin e 3 dhe të 4, ka deklaruar se nuk disponon mandatin për shlyerjen e këstit të tretë në shumën 8.460 USD, pasi e kishte humbur, ndërkohë që prona ishte blerë para 21 vitesh (1997), si rrjedhojë nuk ka pasur ndonjë detyrim ligjor të periudhës përkatëse për të arkivuar mandatpagesat dhe realisht nuk i mbante mend se në cilin datë apo muaj të vitit ishte paguar kësti i tretë. Ndërsa vlera e këstit të katërt, sikurse kishte deklaruar në pyetësonin përkatës, ishte zbritur nga vlera totale për arsye se kishte kryer një pjesë të punimeve të rifiniturës vetë.

1.5 Gjithashtu, në seancën dëgjimore për këstin e katërt, i cili përbente një vlerë më e vogël, deklaroi se kishte pasur probleme me firmën, duke kryer disa punime vetë, dhe se nuk mund ta specifikonte, se sa ishte vlera e punimeve që kishte kryer, por kontrata ishte mbyllur. Deklaroi se e vërteta ishte që marrëdhëniet financiare me firmën ishin likuiduar, dhe se rezultonte e vërtetë se në kontratë kishte thënë se e kishte paguar, dhe në pyetësor kishte thënë, që një pjesë të punimeve i kishte kryer vetë, pra nuk mund të specifikonte se sa ishte paguar dhe sa nuk ishte paguar.

1.6 Në lidhje me faktin që subjekti nuk ka pasur burime financiare të mjaftueshme për blerjen e apartamentit, subjekti ka kërkuar nga Komisioni që në analizën financiare të kryer për të ardhurat dhe shpenzimet të përfshihen edhe të ardhurat familjare të vjehrrit dhe të vjehrrës, duke deklaruar se kishte jetuar gjithmonë në një shtëpi me ata. Gjithashtu, deklaroi se të ardhurat e vjehrrës dhe vjehrrit, i kishte deklaruar edhe në deklaratat periodike nga viti 2012 e vijim, si dhe depozitoi dokumentacion për të vërtetuar të ardhurat e tyre.

1.7 Në lidhje me mungesën e burimeve financiare të ligjshme, subjekti gjithashtu pretendoi se analiza e Komisionit nuk ishte e saktë, pasi Komisioni kishte marrë për bazë kursin e këmbimit të dollarit në datën e pagesës, fakt ky që nuk ishte i saktë, pasi dollarët e përdorur për blerjen e apartamentit, ai nuk i kishte blerë në ditën që janë bërë pagesat por i kishte blerë gjatë viteve 1995, 1996, kur kursi i këmbimit kishte qenë më i favorshëm për subjektin.

1.8 Mbështetur në këto argumenta, dhe dokumentacionin mbi të ardhurat e vjehrrit dhe vjehrrës, subjekti i rivlerësimit paraqiti analizën financiare, sipas të cilës pretendon se nuk ishte në pamundësi financiare për kryerjen e këtij investimi.

1.9 Arsytim ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm:

- ✓ **Mbi mosdeklarimin e saktë të datës/muajit/vitin se kur ishin paguar dy këstet e tjera për blerjen e apartamentit, me sip. 141 m², si dhe mungesës së dokumentacionit për këto pagesa.**

Trupi gjykues, lidhur me mosdeklarimin e saktë të datës/muajit/vitin se kur ishin paguar 2 këstet e fundit për blerjen e apartamentit, me sip. 41 m², si dhe mungesës së dokumentacionit për këto pagesa, në analizë të pretendimeve të ngritura në parashtresë, pas kalimit të barrës provës, por edhe në seancën dëgjimore, vlerëson se:

1.10 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë pagesat e kësteve të çmimit kontraktor në vlerën 28.200 USD, muajin/vitin sipas kushteve kontraktuale të sipërmarrjes nënshkruar me shoqërinë “***” sh.p.k., më datë 05.02.1997, si dhe nuk ka të ardhura të mjaftueshme për justifikimin e blerjes së kësaj pasurie për sa arsyeton:

1.11 Mbi deklarimet për pagesat e kësteve të çmimit, trupi gjykues konstaton mospërputhje deklarimesh si dhe i çmon ato kontradiktore, pasi subjekti i rivlerësimit:

- ✓ Ka deklaruar në deklaratën “Vetting” dhe atë periodike blerjen e pasurisë, apartament banimi, me sip.141m², **kundrejt çmimit 28. 200 USD.**
- ✓ Ka deklaruar gjatë hetimit administrativ, se për këtë pasuri sipas kontratës së porosisë në vitin 1997, kishte realizuar pagesat me këste, për të cilat dispononte vetëm mandatet për dy këstet e para, ndërsa mandatarkëtimin për këstin e tretë nuk e dispononte pasi e kishte humbur edhe likuidimin e këstit të katër nuk e dispononte. Ka deklaruar se përcaktimi i mënyrës së pagesës përshkruhej edhe në kontratën e sipërmarrjes.
- ✓ Ka deklaruar gjatë seancës se për këstin e katërt, i cili përbente një vlerë më të vogël, kishte pasur probleme me firmën, duke kryer disa punime vetë, dhe se nuk mund ta specifikonte, se

sa ishte vlere e punimeve që kishte kryer, por kontrata ishte mbyllur. Deklaroi se e vërteta ishte që marrëdhëniet financiare me firmën ishin likuiduar, dhe se rezultonte e vërtetë se në kontratë kishte thënë se e kishte paguar, dhe në pyetësor kishte thënë që një pjesë të punimeve i kishte kryer vetë, pra nuk mund të specifikonte se sa ishte paguar dhe sa nuk ishte paguar. Subjekti deklaroi se nuk e kishte paguar këstin e katërt.

1.12 Në analizim të deklarimeve të subjektit, trupit gjykues i rezulton se këto deklarime bien ndesh me parashikimet në kontratën e porosisë, sikurse vetë subjekti ka deklaruar gjatë hetimit administrativ, se mënyra e pagesës përshkruhej edhe në kontratën e sipërmarrjes si dhe parashikimet kontraktuale në kontratën e shitblerjes nënshkruar, më datë 25.01.2017, ku referohet se çmimi për blerjen e apartamentit, ishte kryer sipas parashikimeve të kontratës së sipërmarrjes, më datë **05.02.1997**, si dhe palët janë likuiduar dhe nuk kanë pretendime për çmimin.

Trupi gjykues, nën një arsytim logjik, gjykon se nëse Komisioni do bazohej në pretendimet që ka sjell subjekti pas kalimit të barrës së provës, dhe deklarimit të tij në seancë dëgjimore, se kësti i katërt nuk ishte paguar, pasi kishte kryer vetë disa punime shtesë, rezulton se në apartamentin që ka blerë, kostot për punime ekstra, duhet ti shtoheshin analizës financiare, në të kundërt çmimi i likuiduar i blerjes së apartamentit në kontratën e shitblerjes, në vlerën prej 28.200 USD, rezulton fiktiv.

1.13 Gjithashtu, subjekti në asnjë nga pyetësorët drejtuar nga Komisioni nuk e ka prezantuar faktin që nuk ishte paguar kësti i fundit për apartamentin. Vetëm pas kalimit të barrës së provës dhe pasi subjekti u njoh me rezultatet e hetimit, ai pretendoi se kish paguar vetëm 3 këste dhe se këstin e katërt nuk e kish paguar, sepse punimet e ndërtesës nuk ishin në cilësinë e duhur. Rezultoi se vetëm gjatë seancës dëgjimore, u pranua fakti i mospagimit të këstit të katërt, të çmimit të apartamentit.

1.14 Në vlerësimin e trupit gjykues, pretendimi i subjektit se kishte pasur probleme me firmën, duke kryer disa punime vetë, dhe se nuk mund ta specifikonte, se sa ishte vlere e punimeve që kishte kryer, por kontrata ishte mbyllur, mbetet në nivel deklarativ, pasi nuk gjen mbështetje në asnjë fakt apo provë tjetër të provuar gjatë hetimit, apo të provuar nga subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës, si dhe ky fakt nuk gjendet i parashikuar as në kontratën e shitblerjes nënshkruar me sipërmarrësin, më datë 25.01.2017.

Në konkluzionin trupit gjykues, në analizë të deklarimeve dhe provave, vlerëson se çmimi i blerjes deklaruar në kontratën e shitjes në vitin 2017, nuk ka pasqyruar realitetin e fakteve sikurse pranohet nga subjekti në seancën dëgjimore.⁵

- **Lidhur me mungesën e burimeve financiare, për të justifikuar blerjen e apartamentit, si dhe për të përballuar shpenzimet jetike.**

1.15 Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të ngritura në prapësimet e subjektit, pas kalimit të barrës së provës, por edhe në seancën dëgjimore, vlerëson se:

1.16 Mbi pretendimin e subjektit se ai ka bashkëjetuar që nga martesja me prindërit e bashkëshortes, dhe për këtë fakt duhet t'i merren në konsideratë të ardhurat e tyre, trupit gjykues arsyeton se:

⁵ Refero procesverbalin e seancës dëgjimore, më datë 14.12.2018

- ✓ Lidhur me deklarin e subjektit për burimin e ligjshëm të përdorur për blerjen e apartamentit, Komisioni, ka konstatuar se në deklarimet periodike, dhe në deklaratën “Vetting” ka deklaruar se janë përdorur **të ardhurat/kursimet e familjes në vite**. Në këto deklarime nuk rezultonte të ishin deklaruar, se për blerjen e kësaj pasurie, të kishin shërbyer edhe të ardhurat e prindërve të bashkëshortes, si dhe nuk rezultonte që subjekti të kishte depozituar dokumentacion për të ardhurat e pretenduara si burim krijimi. Megjithatë, duke marrë në konsideratë, provat e depozituara për të provuar bashkëjetesën dhe dokumentacionin provues për të ardhurat e tyre pas kalimit të barrës së provës, si dhe faktin se subjekti ka deklaruar të ardhurat e tyre nga viti 2012 e në vijim, Komisioni, vlerëson se shpjegimet dhe provat e subjektit mbi bashkëjetesën me ta, janë bindëse për rrjedhoje e pranoi pretendimin e subjektit, duke përfshirë në analizë financiare të ardhurat e vjehrrës dhe vjehrrit.

1.17 Në vijim, trupi gjykues konstaton se në analizën financiare të paraqitur nga subjekti (tabela nr. 2), për periudhën 1983 -1997, në të cilën pretendon se ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e apartamentit, edhe në konsideratë të pretendimit të tij mbi konvertimin e lekëve në dollar me një kurs më të ulët, si dhe të përfshirjes në përlllogaritje të të ardhurave të vjehrrit dhe vjehrrës, rezulton se **subjekti nuk ka llogaritur shpenzimet jetike të të gjithë familjes, që deri në vitin 1997, përbehej nga 6 anëtarë**. Në këto kushte, Komisioni konstaton se rezultati pozitiv i paraqitur nga ana e subjektit, në shumën **630.885** lekë, nuk është një rezultat i mbështetur në një analizë të saktë, për të provuar aftësitë paguese, si dhe analiza nuk është bindëse për komisionin, pasi subjekti nuk ka përlllogaritur/përfshirë shpenzimet jetike të familjes si fillim me 4 anëtarë (subjekti me b/shorten dhe prindërit e saj) dhe më pas me 6 anëtarë (pas lindjes së dy vajzave) deri në vitin 1997. Në këtë drejtim trupi gjykues ka në konsideratë faktin se shpenzimet jetike, për këtë periudhë subjekti i rivlerësimit nuk i ka qartësuar as gjatë hetimit administrativ si dhe as pas kalimit të barrës së provës.

Tabela nr. 2. Analiza financiare për periudhën 1983 - 1997

Analiza financiare 1983 – 1997	Të dhënat
Të ardhura subjekti, 21.03.1983 – 1997	1.300.793
Të ardhura nga bashkëshortja, 1990 – 1997	564.171
Të ardhura nga pension i vjehrrit, 1991-1997	234.008
Të ardhura nga pension i vjehrrës 1991 - 1997	187.873
Të ardhura totale	2.286.845
Shpenzime blerje apartamenti, 1997 (2.131 751 – 475.790)	-1.655.960
Diferenca pozitive e justifikuar	630.885

1.18 Në vijim trupi gjykues ka konstatuar se në kontratën e sipërmarrjes, më datë **05.02.1997**, me palë investitorë, Gjykatën e Apelit Tiranë, e përfaqësuar në atë kohë, nga subjekti i rivlerësimit, investitori kishte ngarkuar sipërmarrësin për ndërtimin e një godine 6-katëshe, me 18 apartamente, në Rr. “***”, kundrejt një çmimi të përcaktuar dhe në preventivin e punimeve, **brenda një afati 15 muaj**, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës. Referuar afatit 15 muaj dhe mandatpagesës së kështit të dytë, datë **08.12.1997**, rezulton që afati i 15 muajve të përfundonte në vitin 1998.

1.19 Në analizë të fakteve dhe provave Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1983 - 1998, duke u bazuar dhe mbi pretendimet e vetë subjektit si më poshtë:

- ✓ **Kësti i parë në shumën 846. 000 lekë**, e pretenduar e paguar;
- ✓ **Kësti i dytë me arritjen e punimeve në katin e IV në shumën 8.460 USD**, e pretenduar e paguar;
- ✓ **për këstin e tretë, është referuar vlera 8.460 USD**, paguar në vitin 1998 e pretenduar nga subjekti, likuiduar sipas kontratës;
- ✓ **për këstin e katërt, është referuar në vlera 2.820 USD**, për të cilën subjekti ka pretenduar se nuk ia ka paguar shoqërisë së ndërtimit, duke i zbritur nga vlera totale e çmimit të blerjes së pasurisë, pasi i kishte kryer vetë shpenzimet për punimet e rifiniturës.

1.20 Në vijim Komisioni, pas llogaritjeve financiare, duke marrë dhe në konsideratë të ardhurat e vjehrrës e vjehrrit pretenduar nga subjekti dhe pa përfshirë asnjë shpenzim jetik për një familje me 6 anëtarë, vëren se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të paguar këstet e shtëpisë, apo për të përballuar shpenzimet e punimeve të rifiniturës të kryera nga ai vetë sikurse pretendohet. Subjekti, për periudhën 1983 – 1998, rezulton me një gjendje negative në vlerën 184.486 lekë, **duke theksuar se në analizën financiare nuk është përfshirë asnjë shpenzim jetik.**

Tabela nr. 3 Analiza financiare e kryer nga Komisioni për periudhën 1983 - 1998/1998.

Analiza financiare 1983 – 1998	Sipas pretendimeve të subjektit dhe pa përlogaritur asnjë shpenzim jetik për familjen me 6 anëtarë, për periudhën 1983-1998
TotaliTë ardhura subjekti, 21.03.1983 – 1998	1.733.395
Të ardhura nga bashkëshortja, 1990 – 1998	790.120
Të ardhura nga pension i vjehrrit, 1991-1998	294.994
Të ardhura nga pension i vjehrrës 1991 - 1998	239.925
Të ardhura totale	3.058.434
Shpenzime blerje apartamenti, 1997 (2.131.751 – 475.790)	-1.655.960
Shpenzime per blerjen e apartamenti Viti 1998 (Kësti i tretë, vlera 8.460 USD plus shpenzime punime rifiniture, vlera 2.280 USD. Total 11.280 USD, (me kurs këmbim 1USD =140.68 lekë)	-1.586.870
Rezultati financiar (Mungese aftesie paguese)	-184.486

1.21 Për sa më sipër, bazuar dhe në provat e administruara dhe deklaratimet e subjektit, duket se subjekti është në pamundësi financiare, që me të ardhurat e realizuara sipas pretendimeve të tij, të paguajë këstet për blerjen e apartamentit, dhe të përballojë shpenzimet e jetesës sipas kohës, të cilat në analizën financiare të komisionit nuk janë përfshirë.

1.22 Baza Ligjore

Bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, deklaratimet e subjektit gjatë hetimit dhe shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- ✓ Referuar rezultateve të hetimi administrativ kryesisht, subjekti i rivlerësimit dukej se kish bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, për këtë fakt subjektit i kaloi barra e provës në lidhje me datën/muajin/vitin se kur janë paguar 2 këstet e fundit (i treti dhe i katërti) për blerjen e apartamentit, me sip. 141 m², ndërsa edhe pas rillogaritjeve, në konsideratë të pretendimit të subjektit për përfshirjen e të ardhurave të vjehrrës dhe vjehrrit, rezulton se

subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratime të pasakta, lidhur me kohën dhe çmimin e paguar për këstin e katërt, si dhe nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar pasurinë apartament, me sip. 141 m², dhe për të kryer shpenzimet jetike për familjen në momentin e bashkëjetesës me prindërit e bashkëshortes me 4 dhe më vonë me 6⁶ anëtarë.

- ✓ Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë referuar paragrafit 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

2. Për deklarinin në lidhje me pasurinë, tokë arë, me sip. 410 m², me vlerë 108.363 lekë, ndodhur në ZK *, ***, Pogradec, blerë nga bashkëshortja M. Q., me kontratën e shitblerjes, nr. *** rep., nr. *** kol, datë 28.02.2012. Burimi i krijimi të deklaruar: kursime familjare. Pjesa takuese e subjektit: 50 %.**

2.1 Mbi deklarinin e shpenzimeve të kryera në vitin 2012 kur është blerë toka, rezulton se përveç shpenzimeve për blerjen e tokës, subjekti i rivlerësimit, ka kryer shpenzime për: blerjen nëpërmjet qirasë financiare të automjetit, tip “**”, “Tirana Leasing”, si dhe ka pasur shpenzime qiraje financiare për automjetin, tip “****”, blerë dhe ky automjet nëpërmjet qirasë financiare, më datë 30.11.2010, shpenzime mjekësore, shpenzime arredimi, shkollimi, udhëtimi, si dhe shpenzimet jetike të familjes së tij.**

2.2 Për asetin, tokë arë, me sip. 410 m², subjekti ka paraqitur:

Për këtë aset subjekti ka paraqitur:

- ✓ Kontratë shitblerje, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28. 02.2012, me palë shitëse: Ll. B., i cili është dhe përfaqësues me prokurë dhe i disa personave të tjerë, palë blerëse: M. Q., vlera 108.363 lekë.
- ✓ Kartelë pasurie me të dhëna: ZK ***, nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, arë, me sip. 410 m², në pronësi të M. Q.

2.3 Faktet e rezultuara nga hetimi administrative, mbi pasurinë, tokë arë, me sip. 410 m² dhe shpenzimet e kryera në vitin 2012.

2.4 Në deklaratën “Vetting” deklarohet pasuria, tokë arë, me sip. 410 m², me vlerë 108.363 lekë, ndodhur në ZK. *, ***, Pogradec, blerë nga bashkëshortja M. Q., me kontratë shitblerje, nr. *** rep., nr. *** kol, datë 28.02.2012. Burimet e krijimi të deklaruar kursime familjare. Pjesa takuese e subjektit: 50 %.**

2.5 Rezulton se kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, plotësuar deklarata në datën 20.03.2012 (deklaruar gabimisht jo në vitin përkatës të deklarimit).

2.6 Nga hetimi administrativ, rezulton se ZVRPP-ja⁷ Pogradec, me shkresën nr. * prot., datë**

⁶ Në momentin e pretenduar për bashkëjetesën, nga viti 1990 me 4 anëtarë, në vitin 1991, me 5 anëtarë, dhe 1993 -1997, familja përbëhej nga 6 anëtarë.

⁷ Në dosjen e subjektit ndodhen shkresat e Komisionit, nr. *** prot., datë 05.02.2018, drejtuar ZVRPP, më të cilën është kërkuar informacion mbi pasuritë e regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

22.02.2018, ka konfirmuar se znj. M. S. Q., ka të regjistruar pranë ZVRPP-së Pogradec, pasurinë nr. ***, vol. ***, fq. ***, ZK ***, e llojit “arë”, me sip 410 m² sipas AMTP-së dhe 420 m² sipas librit të ngastrave.

2.7 Në dosje janë të administruara, kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol, datë 28.02.2012, me palë shitëse: Ll. B., i cili është dhe përfaqësues me prokurë i tre bashkëpronarëve të tjerë, të kësaj pasurie dhe palë blerëse: M. Q., vlera 108.363 lekë. Në kontratë është parashikuar se shitësi i shet blerësit pasurinë, tokë arë, me çmim në vlerën 108.363 lekë. Vlera e çmimit të blerjes ishte paguar nga blerësi përpara redaktimit të kësaj kontrate.

2.8 Komisioni, krijoi dyshime në lidhje me çmimin e ulët, të blerjes së kësaj pasurie, për rrjedhojë i kërkoi, ZVRPP-së Pogradec, dosjen e plotë të kësaj pasurie, që nga origjina e saj, informacion mbi çmimin e referencës së pasurive në këtë zonë dhe në këtë vit, si dhe praktika të tjetra të ngjashme për të cilën është përdorur i njëjti çmim.

2.9 Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Pogradec, rezultoi se kjo pasuri ishte përfituar nga pronarët e mëparshëm (shitësit) nëpërmjet trashëgimisë. Trashëgimlënësi, e kishte përfituar këtë pasuri sipas ligjit nr. 7501/1991, “Për Tokën”, i ndryshuar. Praktika e përfitimit të kësaj pasurie nga ish-pronari dhe trashëgimtarët e tij, si dhe transferimi i kësaj pasurie te subjekti i rivlerësimit ishte kryer nëpërmjet kontratës së shitblerjes, nr. *** rep., nr. *** kol, datë 28. 2.2012. Në lidhje me çmimin e referencës, ZVRPP-ja Pogradec ka konfirmuar se për këtë zonë, është zbatuar VKM-ja, nr. 1620, datë 26.11.2008, “*Për miratimin e çmimeve të trojeve, që ndodhen në të gjitha bashkitë dhe në disa komuna*”, i ndryshuar, ku çmimi për, tokën arë, rezultoi të jetë në vlerën 264.3 lekë. Në bazë të kërkesës së Komisionit, ZVRPP-ja Pogradec, depozitoi edhe një praktikë të ngjashme, ku rezultoi se çmimi i referencës për blerjen e një pasurie, ngjitur me tokën ku kishte blerë subjekti, ishte në të njëjtën çmim 264.3 lekë.

2.10 Në vijim nga verifikimet ligjore të kryera, Komisionit, i rezultoi se sipas VKM-së, nr. 16, datë 12.01.2011, “*Për shpronësim për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që prekte nga ndërtimi i segmentit rrugor ***– *** – Pogradec, Loti I*”, çmimi me të cilin janë kompensuar pronarët për zonën e ***, ishte po në vlerën 264.3 lekë për m².

2.11 Gjithashtu Komisioni, përmes pyetësorit, më datë 21.09.2018, i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime në lidhje gjendje juridike të pasurisë “Arë” në * të Pogradecit si dhe nëse kjo pasuri kish pësuar ndryshime që nga momenti i blerjes së saj. Subjekti i rivlerësimit deklaroi pranë Komisionit, më datë 27.09.2018, se statusi juridik i pasurisë së ndodhur në fshatin ***, Pogradec, e llojit "Arë", nuk kishte pësuar asnjë ndryshim.**

2.12 Në analizim të fakteve dhe provave, Komisionit i rezultoi se çmimi i blerjes së pasurisë sipas kontratës së shitblerjes, bazohej në VKM-në, nr. 1620, datë 26.11.2008, “*Për miratimin e çmimeve të trojeve, që ndodhen në të gjitha bashkitë dhe në disa komuna*”, i ndryshuar, për rrjedhojë nuk kishte më dyshime lidhur me çmimin e saj.

2.13. Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ në lidhje me shpenzimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, në vitin 2012.

2.14 Rezulton se subjekti i rivlerësimit, ka kryer shpenzime për shlyerjen e qirasë financiare për blerjen e automjetit, tip “Volksäagen Polo”, në vitin 2010, sipas konfirmimit nga shoqëria “Landeslease”.

2.15 Rezulton se subjekti i rivlerësimit, ka kryer shpenzime për shlyerjen e qirasë financiare për blerjen e automjetit tjetër tip “Renault Koleos”, në vitin 2012, sipas konfirmimit nga shoqëria “Raiffeisen Leasing” .

2.16 Në pyetësorin standard të Komisionit, në pyetjen me përmbajtje: “Sa ishte vlera e arredimit të shtëpisë /ve së tij, duke specifikuar natyrën dhe kostot e çdo rinovimi, orendive, dekorimeve dhe pajisjeve elektrike apo elektronike në shtëpinë/shtëpitë/apartamentet, që tejkalonin shumën prej 2.500 eurosh secila, pesë vitet e fundit, e nëse është e mundur, të viheshin në dispozicion faturat”, Subjekti ka deklaruar se: “Vlera e arredimit të shtëpisë në total ka qenë 25.000 euro, dhe rinovim kishte bërë vetëm për këndin e kolltukëve në ambientin e ndenjes në vlerë 5.000 euro”.

2.17 Më kërkesën e Komisionit sipas pyetësorit të datës 27.09.2018, për të dhënë deklarime mbi periudhën kur ishte bërë arredimi i shtëpisë, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: “a) Arredimi i shtëpisë ku banon familja e tij kishte filluar përpara vitit 2005, vit ku i ishte dhuruar banesa pasi kishin jetuar në atë shtëpi që nga momenti i ndërtimit dhe regjistrimit që përkon me vitin 1995. b) Një pjesë e kursimeve nga viti 2005 deri në vitin 2011, të deklaruara në deklaratat periodike ishin përdorur vit pas viti për arredim dhe pjesa tjetër e kursimeve ishte përdorur për mbulimin e shpenzimeve në vitet pasardhëse”.

2.18 Nga shkresa e ZQRPP-së, nr. *** prot., datë 04.10.2018, në lidhje me udhëtimet për shkak të detyrës të zj. M. Q., janë konfirmuar udhëtimet dhe vlerat e rimbursuara për arsye pune. Gjithashtu, nga sistemi *TIMS* i aksesueshëm nga Komisioni, u verifikuan udhëtimet e kryera të subjektit të rivlerësimit dhe personave të tjerë të familjes së tij.

2.19 Për të verifikuar burimet e ligjshme të përdorura për blerjen e pasurisë, dhe shpenzimet e kryera në vitin 2012, Komisioni kreu analizën financiare në vitin 2012, vit në të cilin specifikisht ishte blerë pasuria, tokë “arë”, dhe ndërkohë ishin kryer shpenzime për qiranë financiare për blerjen e një automjeti, tip “Renault Tirana Leasing”, për qiranë financiare për blerjen e automjetit, tip “Volksäagen Polo”, më datë 30.11.2010, shpenzime mjekësore, arredimi, shkollimi, udhëtimi, si dhe shpenzimet jetike të familjes së tij, të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 4

	Përshkrimi	2012
1	PASURI	4.090.383
	Autoveturë , tip “Polo”	0
	Tokë arë , sip 410 m ² , *** ,Pogradec	108.363
	Autoveturë, tip “Renault Koleos”	3.982.020
2	DETYRIME	2.018.490
	Leasing për Volksä agen Landeslease	-390.247
	Leasing për blerje Renault Tirana Leasing.	2.408.736
3	PASURI NETO (1-2)	2.071.893

4	TË ARDHURA		3.075.575
	Të ardhura subjekti		1.270.209
	Të adhura bashkëshortja		397.886
	Të ardhura nga paga e vajzës së subjektit		150.000
	Të adhura nga vendimi gjyqësor, nr. ***		0
	Të ardhura nga paga, vajza e dytë e subjektit		0
	Të ardhura nga shitja e makinës		0
	Dhurim për arsye shë ndetë sore		1.257.480
5	SHPENZIME		3.685.122
	Interesa Leasing Landeslease		92.078
	Interesa Leasing Tirana Leasing		0
	Shpenzime ILDKPKI		817.905
	Shpenzime mjeksore		1.257.480
	Shpenzime udhëtimi sipas <i>TIMS</i> dhe pyetësorit		808.979
	Shpenzime në Holandë vajza madhe e subjektit		0
	Shpenzime arredimi sipas pyetësorit, datë 16.10.2018		300.000
	Shpenzime shkollimi të djalit të subjektit		408.681
6	LIKUIDITETE NË FILLIM TË VITIT		1.262.920
	“Credins Bank”, M. Q. 230382	lekë	2.970
	“Credins Bank”, Fatos Qato 81494	lekë	57.256
	“Raiffeisen Bank”, Fatos Qato 854160	lekë	40
	“Raiffeisen Bank”, M. Q. 024579	lekë	18.956
	“Union Bank”, M. Q. 111296568060114	lekë	56.595
	Intesa, M. Q. 455019	lekë	-1.879
	Intesa, M. Q. 455019	euro	0
	Intesa, M. Q. 455019	euro	262
	Intesa, M. Q. 455019	euro	5.732
	CASH	lekë	300.000
7	LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT		1.172.778
	“Credins Bank”, M. Q. 230382	lekë	7.290
	“Credins Bank”, Fatos Qato 81494	lekë	22.277
	“Raiffeisen Bank”, Fatos Qato 854160	lekë	40
	“Raiffeisen Bank”, M. Q. 024579	lekë	27.938
	“Union Bank”, M. Q. 111296568060114	lekë	65.920
	“Union Bank”, K. Q. 119416975060112	lekë	0
	Intesa, M. Q. 455019	lekë	-7.621
	Intesa, M. Q. 455019	euro	3
	Intesa, M. Q. 455019	euro	1.691
	Intesa, M. Q. 455019	euro	5.871
	CASH	lekë	0
8	DIFERENCA (TË ARDHURA – PASURI - SHPENZIME 4+6-3-5-7)		-2.591.299

2.20 Nga përlllogaritjet e kryera, lidhur me investimet dhe shpenzimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në këtë vit, në raport me të ardhurat, dukej se subjekti nuk kishte pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e tokës, si dhe për të kryer shpenzime për qiranë financiare për blerjen automjeti tip “Renault”, Tirana Leasing, për qiranë financiare për blerjen e automjetit “Volksäagen Polo” shpenzimet mjekësore, arredimit, shkollimi, udhëtimi, si dhe shpenzimet jetike të familjes

së tij, të pasqyruara në tabelën e nr. 4, e për pasojë i kaloi barrën e provës subjektit për të provuar të kundërtën.

2.21 Komisioni, për vërtetimin e fakteve dhe burimit të të ardhurave, administroi nga institucionet publike e private dhe mori deklaramë të vetë subjektit me anë të postës elektronike, si më poshtë:

2.22 Shkresën nr. *** prot., datë 22.02.2018, të ZVRPP-së⁸ Pogradec, ku konfirmohet se në emër të bashkëshortes së subjektit është regjistruar, pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, ZK ***, lloji i pasurisë, arë, me sip. 410 m², sipas AMTP-së dhe sip. 420 m² sipas librit të ngastrave.

2.23 Korrespondencë nëpërmjet postës elektronike me ZVRPP-së Pogradec, e datës 08.10.2018, ku u parashtrua çmimi i referencës si dhe u depozitua një praktikë e ngjashme me rastin në shqyrtim.

2.24 Shkresë e shoqërisë “Landeslease”, me nr. *** prot., datë 09.02.2018, që konfirmon kontratën e qirasë financiare ndërmjet kësaj shoqërie dhe znj. M. Q., për blerjen e një automjeti, tip “Volksäagen Polo”, sipas kontratës, nr. *** prot., datë 30.11.2010.

2.25 Shkresë e shoqërisë “Raiffeisen Leasing”, me nr. *** prot., datë 20.02.2018, që konfirmon kontratën e qirasë financiare ndërmjet kësaj shoqërie dhe Fatos dhe M. Qatos, për blerjen e një automjeti, tip “Renault Koleos”, sipas kontratës nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 02.08.2012.

2.26 Shkresat për të ardhurat, e subjektit dhe bashkëshortes cituar më lartë në pikën **1.4.5**.

2.27 Shkresa e Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. *** prot., datë 26.09.2018, në lidhje me udhëtimet për shkak të detyrës të subjektit të rivlerësimit.

2.28 Shkresa e ZQRPP-së, nr. *** prot., datë 04.10.2018, në lidhje me udhëtimet për shkak të detyrës të zj. M. Q.

2.29 Deklarimet e subjektit, në pyetësorin standard të Komisionit, të datës 12.02.2018, përgjigjet e pyetësorit të datës 27.09.2018, përgjigjet e pyetësorit të datës 16.10.2018 dhe të datës 26.10.2018.

2.30 Subjekti i rivlerësimit, me anë të shpjegimeve dhe provave të depozituar, më datë **06.12.2018**, si dhe deklaramëve në seancën dëgjimore, më datë **14.12.2018**, ka argumentuar se:

2.31 Subjekti ka pretenduar se në analizën financiare të Komisionit nuk ishin përfshirë të ardhurat nga prindërit e bashkëshortes që jetojnë me të që nga viti 1990 deri me sot. Subjekti ka kërkuar t’i përfshihen në përlllogaritje të ardhurat e vjehrrit nga pensioni si ushtarak dhe të vjehrrës

⁸ Në dosjen e subjektit ndodhen shkresat e Komisionit, nr. *** prot., datë 05.02.2018, drejtuar ZVRPP-ve, më të cilën është kërkuar informacion mbi pasuritë e regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

pensionin si mësuese rusishte, përkatësisht që nga viti 1990 - 2017 e vërtetuar kjo me dokumentacionin e institucionit përkatës, pasi ato ishin të ardhura reale.

2.32 Subjekti, gjithashtu ka pretenduar se: shpenzimet për arredim të shtëpisë në vlerën 25.000 euro, nuk janë bërë sikurse i ka llogaritur Komisioni nga viti 2005 e në vijim. Subjekti ka pretenduar se arredimi i shtëpisë ishte bërë për një periudhë 28-vjeçare që nga data e martesës e deri më sot, nga pjesëtarët e familjes.

2.33 Subjekti ka kërkuar që shpenzimet për arredim në shumën 25.000 euro (2.700.000 lekë) të mos llogariten si shpenzime të kryera totalisht gjatë periudhës 2003 - 2016, por të shpërndahen ndër vite që nga vitit 1990 - 2016.

2.34 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm:

Lidhur me mungesën e burimeve financiare, për të justifikuar blerjen pasurisë, tokë arë, si dhe për të përballuar shpenzimet e kryera në vitin 2012, për blerjen e automjeteve, tip “Renault Koleos” dhe automjetit tip “Volksëagen Polo”, nëpërmjet qirave financiare, shpenzime mjekësore, arredimi, shkollimi, udhëtimi, si dhe shpenzimet jetike të familjes së tij:

2.35 Trupi gjykues në analizë të pretendimeve të ngritura në parashtresë, pas kalimit të barrës provës, por edhe në seancën dëgjimore, vlerëson se:

2.35.1 Pasi u krye analiza financiare duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit për përfshirjen e të ardhurave të vjerrit dhe të vjerrës, sipas tabelës vijuese 4.1, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka patur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar, blerjen e pasurisë, tokë arë, si dhe për të përballuar shpenzimet e kryera në vitin 2012.

Tabela nr. 4.1

	Përshkrimi	Viti 2012
1	PASURI	4,090,383
	Tokë arë sip 410m2 *** Pogradec	108,363
	Autoveturë Renault Koleos	3,982,020
2	DETYRIME	2,018,490
	Leasing për blerje Volksëagen Polo Landeslease	-390,247
	Leasing për blerje Renault Tirana Leasing.	2,408,736
3	PASURI NETO (1-2)	2,071,893
4	TË ARDHURA	3,822,629
	Të ardhura subjekti	1,270,209
	Të ardhura bashkëshortja	397,886
	Të ardhura vjehri	537,553
	Të ardhura vjehra	209,501
	Të ardhura nga paga e vajzës	150,000
	Dhurim nga vellezër dhe shokë për arsye shendetesore	1,257,480
5	SHPENZIME	4,012,284
	Interesa leasing Landeslease	92,078
	shpenzime ILDKPKI	817,905

	shpenzime jetese vjehri vjehra	327,162
	Shpenzime mjeksore	1,257,480
	Shpenzime udhëtimi sipas TIMS dhe pyetësorit	808,979
	Shpenzime arredimi sipas pyetësorit dt 16/10/2018 25.000 euro.	300,000
	Shpenzime shkollimi djali	408,681
6	LIKUIDITETE NË FILLIM TË VITIT	1,262,920
	Credins Bank M. Q. 230382	2,970
	Credins Bank Fatos Qato 81494	57,256
	Raiffeisen BankFatos Qato 854160	40
	Raiffeisen Bank M. Q. 024579	18,956
	Union Bank M. Q. 111296568060114	56,595
	Union Bank K. Q. 119416975060112	0
	Intesa M. Q. 455019	-1,879
	Intesa M. Q. 455019	0
	Intesa M. Q. 455019	262
	Intesa M. Q. 455019	5,732
	CASH	300,000
7	LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT	1,172,778
	Credins Bank M. Q. 230382	7,290
	Credins Bank Fatos Qato 81494	22,277
	Raiffeisen Bank Fatos Qato 854160	40
	Raiffeisen Bank M. Q. 024579	27,938
	Union Bank M. Q. 111296568060114	65,920
	Union Bank K. Q. 119416975060112	0
	Intesa M. Q. 455019	-7,621
	Intesa M. Q. 455019	3
	Intesa M. Q. 455019	1,691
	Intesa M. Q. 455019	5,871
	CASH	0
	DIFERENCA (TË ARDHURA -PASURI-SHPENZIME 4+6-3-5-7)	-2,171,407

2.35.2 Përlllogaritjet e Komisionit janë të bazuara në deklaratimet e kryera nga vetë subjekti në deklaratën “Vetting”, deklaratimet periodike si dhe ato gjatë hetimit administrativ, të provuara edhe nga institucionet publike, që në kuptim të nenit 32, pika 5, e ligjit nr. 84/2016, përbejnë provë për Komisionin.

Situata financiare e subjektit në vitet 2003-2016

3. Komisioni, duke konstatuar se shpenzimet e kryera nga ana e subjektit të përlllogaritura, dhe arsyetuar sa më sipër për vitin 2012, ishin shpenzime të kryera ndër vite dhe me natyrë të ndryshme, kreu analizën e plotë financiare për vitet 2003 - 2016, për të hetuar nëse subjekti i rivlerësimit kishte mundësi financiare për të kryer investime, përballuar shpenzimet në raport me të ardhurat që kish përfituar.

3.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ, në lidhje me shpenzimet e kryera të vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit për periudhën 2003 - 2016:

3.2. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, përveç shpenzimeve për pasuritë e trajtuara më sipër, automjeteve, arredimit, ka kryer edhe shpenzime që lidhen me kurimin e tij, shkollimin e fëmijëve, si dhe të jetesës, duke kryer përlllogaritjet financiare.

3.3 Për llogaritjen e shpenzimeve mjekësorë, të shkollimit të fëmijëve si dhe të arredimit, u morën për bazë vlerat e deklaruara nga vetë subjekti në përgjigje të pyetësorëve të dërguar pranë Komisionit.

3.4 Rezulton se subjekti ka deklaruar në pyetësorin standard të Komisionit si dhe gjatë hetimit administrativ se shpenzimet e arredimit të shtëpisë në total kanë qenë 25.000 euro, dhe shpenzimet për rinovim këndin të kolltukëve, në vlerën 5.000 euro, dhuruar nga prindërit e bashkëshortes. Në përgjigjet e pyetësorit, të datës 27.09.2018, subjekti ka deklaruar se: “Arredimi i shtëpisë** kishte filluar përpara vitit 2005, vit kur i ishte dhuruar banesa pasi kishte jetuar në atë shtëpi që nga momenti i ndërtimit dhe regjistrimit që përkon me vitin 1995. **Një pjesë e kursimeve nga viti 2005 deri në vitin 2011** të deklaruara në deklaratat periodike i kishte përdorur vit pas viti për arredim dhe pjesa tjetër e kursimeve ishte përdorur për mbulimin e shpenzimeve në vitet pasardhëse”.**

3.5 Subjekti mbi kërkesën e Komisionit sipas përgjigjeve të pyetësorit, të datës 16.10.2018, **për të specifikuar çdo vit vlerat përkatëse për arredimin e shtëpisë, deklaroi** se: “Shpenzimet për arredim apo ndonjë kërkesë bazë jetësore familjare kishin qenë kryesisht shumtë e kursyera në vitin respektiv paraardhës. Subjekti saktësoi se në fund të vitit 2005, kishte pasur kursime *cash*, shumën prej 600.000 lekësh, të cilat i kishte shpenzuar për arsyet e mësipërme në vitin pasardhës 2006; në vitin 2007 kishte shpenzuar për arsyet e mësipërme kursimet e vitit 2006; në vitin 2008 kishte shpenzuar për arsyet në fjalë kursimet e vitit 2007; në vitin 2009 kishte shpenzuar për arsyet në fjalë kursimet e vitit 2008; në vitin 2010 kishte shpenzuar kursimet e vitit 2009; dhe, në vitin 2012 kishte shpenzuar kursimet e vitit 2011. Këtyre shpenzimeve për arredim i shtohet edhe vlera e këndit e blerë nga prindërit e bashkëshortes.

3.6. Në vijim Komisioni pasi konstatoi se subjekti në deklaratat periodike pas vitit 2011, nuk kishte pasur deklarime të shtesave dhe pakësimi të gjendjes *cash*, i kërkoi deklarime subjektiv mbi akumulimin e gjendjes së likuiditetit *cash* për vitet 2005 - 2011. Subjekti mbi këtë kërkesë të Komisionit, deklaroi se: “*nuk dispononte gjendje cash të lekëve pasi shumën e kursyer deri në 2011, e kishte përdorur një pjesë për arredimin e shtëpisë dhe pjesën tjetër i kishte përdorur për shpenzimet e viteve pasardhëse kryesisht për shkollimin e fëmijëve*”.

3.7 Llogaritjet lidhur me shpenzimet e jetesës, Komisioni, i bëri në bazë të vlerës së përcaktuar në raportin e ILDKPKI-së, duke theksuar se në vitet 2014 - 2016, nuk u përfshinë vajzat e subjektivit duke pasur në konsideratë se kanë qenë me studime dhe punësim në Holandë.

3.8 Për udhëtimet jashtë shtetit, Komisioni, u bazua në të dhënat nga sistemi *TIMS* dhe për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit morri si bazë shpenzimet mesatare të udhëtimeve sipas linjave ajrore duke filluar nga 180 euro për udhëtim për linjat low cost deri në 300 euro për udhëtim për linjat më të gjata. Ndërsa për shpenzimet e qëndrimit u llogaritur 50 euro/ditë shpenzim qëndrimi dhe ushqimi.

3.9 Në rastet kur qëndrimi është deklarua te familjarët e subjektit dhe bashkëshortes janë llogaritur shpenzimet e udhëtimit si më lart, si dhe kosto qëndrimi 20 euro/ditë. Shpenzimet e deklaruara për udhëtime pune, që janë konfirmuar nga institucioni përkatës, nuk janë përfshirë në llogaritje.

3.10 Lidhur me të ardhurat nga qiraja të deklaruara në vitet 2007 dhe 2012 - 2014 , Komisioni, konstatoi se ato janë krijuar nga një aktivitet i ligjshëm siç është qiradhënia e një pasurie të paluajtshme, por në kushtet që nga institucioni i drejtorisë tatimore, dhe deklaratimet e vetë subjektit, konfirmohet se nuk ishte paguar tatimi mbi të ardhurat e realizuara nga qiraja, nuk u morën në konsideratë pasi janë të ardhura të paligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3.11 Nga analiza financiare pasqyruar në tabelën nr. 3, Komisionit i rezultoi se për vitet 2005, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2014, 2015, subjekti rezulton me gjendje negative, dhe për rrjedhojë i kaloi barrën e provës, për pamjaftueshmëri të mbulimit të pasurisë dhe shpenzimeve të kryera me burimet financiare të deklaruara dhe dokumentuar, në total⁹ në **vlerën 8.324.055 lekë.**

Tabela nr. 5 vijuese

⁹ Refero tabelen në faqen vijuese nr.23

Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
1 PASURI	0	0	0	0	0	0	0	2 179 317	0	4 090 383	0	0	0	0	
Shtepi banimi Rr ***	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Autoveturë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shtepi banimi dhurate nga vjehrra rr ***	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Autoveture Polo	0	0	0	0	0	0	0	2 179 317	0	0	0	0	0	0	0
Tokë are sip 410m2 *** Pogradec	0	0	0	0	0	0	0	0	0	108 363	0	0	0	0	0
Autoveturë Renault Koleos	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3 982 020	0	0	0	0	0
2 DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	1 108 526	-401 527	2 018 490	-771 373	-489 965	-569 458	-515 379	
Leasing për blerje Volkswagen Polo Landeslease	0	0	0	0	0	0	0	1 108 526	-401 527	-390 247	-321 019	0	0	0	0
Leasing për blerje Renault Tirana Leasing.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2 408 736	-450 355	-489 965	-569 458	-515 379	0
3 PASURI NETO (1-2)	0	0	0	0	0	0	0	1 070 791	401 527	2 071 893	771 373	489 965	569 458	515 379	
4 TË ARDHURA	1 129 463	1 393 213	1 414 717	1 696 629	1 573 167	1 252 596	1 302 654	1 538 931	1 417 739	3 075 575	4 153 300	2 514 847	2 515 727	4 298 404	
Të ardhura subjekti	753 816	1 012 347	1 024 183	1 091 790	1 111 202	1 123 536	1 170 054	1 189 660	1 238 819	1 270 209	1 288 384	1 374 638	1 384 073	1 408 257	0
Të adhura bashkëshortja	375 647	380 866	390 534	604 839	461 965	129 060	132 600	349 271	178 920	397 886	407 577	1 140 209	1 106 654	1 065 172	0
Të adhura nga qiraja Rr ***	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	248 625	0
Të ardhura nga paga e vajzës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	150 000	0	0	0	0	0
Të adhura nga vendimi gjyqësor nr *** dt 10.06.2008	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1 756 289	0	0	0	0
Të ardhura nga paga vajza e dyte	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	25 000	0	0
Të ardhura nga shitja e makinës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	701 050	0	0	900 000	0
Të ardhura nga shitja e Volkswagen Polo	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Dhurim nga vellezër dhe shokë për arsye shendetesore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1 257 480	0	0	0	0	0
Dhurim nga vjehrra për arredim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	676 350	0
5 SHPENZIME	594 657	645 353	1 131 185	1 574 209	1 535 123	1 583 757	1 629 281	1 599 703	1 770 796	3 685 122	2 220 456	3 881 474	2 158 310	3 167 702	
Interesa leasing Landeslease	0	0	0	0	0	0	0	7 011	94 739	92 078	75 744	0	0	0	0
Interesa leasing Tirana Leasing	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	222 653	238 607	61 943	76 698	0
Shpenzime jetike sipas ILDKPKI	594 657	594 657	726 803	726 803	726 803	817 905	817 905	817 905	817 905	817 905	817 905	625 598	695 778	517 627	0
Shpenzime mjeksore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1 257 480	0	0	0	0	0
Shpenzime arredimi financiar nga vjehrra	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	676 350	0
Shpenzime udhëtimi sipas TIMS dhe pyetësorit	0	50 696	404 382	247 406	308 321	365 852	311 376	305 382	457 773	808 979	694 040	645 907	550 600	673 645	0
Shpenzime shkollimi dhe jetese në Hollandë vajza madhe	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1 821 430	412 950	0	0
Shpenzime shkollimi dhe jetese në Hollandë vajza vogël	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	966 369	0
Shpenzime arredimi sipas pyetesorit dt 16/10/2018 25.000 euro.	0	0	0	600 000	500 000	400 000	500 000	400 000	0	300 000	0	0	0	0	0
Shpenzime shkollimi djali	0	0	0	0	0	0	0	69 405	400 379	408 681	410 114	549 932	437 039	257 013	0
6 LIKUIDITETE NË FILLIM TË VITIT	0	0	634 779	557 470	1 015 076	1 327 062	1 257 915	875 473	1 262 920	1 172 778	1 068 143	1 186 508	1 169 679	1 105 742	
Credins Bank M. Q. 230382	lekë	0	0	0	0	0	0	0	0	2 970	7 290	7 290	7 290	7 290	0
Credins Bank Fatos Qato 81494	lekë	0	0	0	0	0	74 107	8 260	1 464	57 256	22 277	3 818	9 302	35 025	0
Raiffeisen BankFatos Qato 854160	lekë	0	8 393	12 251	3 096	40	40	40	40	40	40	40	40	40	40
Raiffeisen Bank M. Q. 024579	lekë	0	26 386	45 218	7 736	14 248	40 171	24 334	18 956	27 938	143 026	206 839	152 132	0	0
Union Bank M. Q. 111296568060114	lekë	0	0	0	0	0	0	42 360	24 540	56 595	65 920	23 796	7 927	7 630	0
Union Bank K. Q. 119416975060112	lekë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	26 343	0
Intesa M. Q. 455019	lekë	0	0	0	0	-306	81 257	18 907	32 298	-1 879	-7 621	0	0	0	0
Intesa M. Q. 455019	euro	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	3	503	462	0
Intesa M. Q. 455019	euro	0	0	0	0	0	148	113	155	262	1 691	337	219	271	0
Intesa M. Q. 455019	euro	0	0	0	0	5 000	5 189	5 341	5 556	5 732	5 871	6 009	6 095	6 105	0
CASH	lekë	0	0	600 000	500 000	400 000	500 000	400 000	0	300 000	0	0	0	0	0
7 LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT	0	0	634 779	557 470	1 015 076	1 327 062	1 257 915	875 473	1 262 920	1 172 778	1 068 143	1 186 508	1 169 679	1 105 742	
Credins Bank M. Q. 230382	lekë	0	0	0	0	0	0	0	0	2 970	7 290	7 290	7 290	7 290	0
Credins Bank F. Q. 81494	lekë	0	0	0	0	74 107	8 260	1 464	57 256	22 277	3 818	9 302	35 025	3 673	0
Raiffeisen BankFatos Qato 854160	lekë	0	8 393	12 251	3 096	40	40	40	40	40	40	40	40	40	0
Raiffeisen Bank M. Q. 024579	lekë	0	26 386	45 218	7 736	14 248	40 171	24 334	18 956	27 938	143 026	206 839	152 132	116 535	0
Union Bank M. Q. 111296568060114	lekë	0	0	0	0	0	0	42 360	24 540	56 595	65 920	23 796	7 927	7 630	7 647
Union Bank K. Q. 119416975060112	lekë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	26 343	0
Intesa M. Q. 455019	lekë	0	0	0	0	-306	81 257	18 907	32 298	-1 879	-7 621	0	0	0	0
Intesa M. Q. 455019	euro	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	3	503	462	12
Intesa M. Q. 455019	euro	0	0	0	0	0	148	113	155	262	1 691	337	219	271	1 055
Intesa M. Q. 455019	euro	0	0	0	0	5 000	5 189	5 341	5 556	5 732	5 871	6 009	6 095	6 105	6 108
CASH	lekë	0	0	600 000	500 000	400 000	500 000	400 000	0	300 000	0	0	0	0	0
DIFERENCA (TË ARDHURA -PASURI-SHPENZIME 4+6-3-5-7)	534 806	747 860	-351 247	199 730	-419 563	-643 147	-257 479	-749 121	-1 142 031	-2 591 299	1 266 106	-1 974 956	-195 211	679 260	-4 896 293
											9 Vite me rezultat negativ		Gjithsej		-8 324 055

3.12 Komisioni, për vërtetimin e fakteve dhe burimit të të ardhurave, administroi nga institucionet publike dhe private, dhe mori deklaramë të vetë subjektit me anë të postës elektronike, si më poshtë:

3.12.1 Shkësën nr. *** prot., datë 20.02.2018, të “Raiffeisen Leasing”, përmes së cilës Komisioni u informuar se në emër të M. dhe Fatos Qatos, figuron kontrata e qirasë financiare, nr. TL ***, kontratë e transferuar nga “Tirana Leasing” sh.a., datë 12.11.2015. Më datë 21.07.2017, është nënshkruar kontrata e shitblerjes së automjetit ndërmjet “Raiffeisen Leasing” dhe Fatos dhe M. Q., për automjetin, tip “Renault Koleos”, vlera totale e të cilit është 28.500 euro, automjet me targë ***.

3.12.2 Shkësë e shoqërisë “Landeslease” sh.a., nr. *** prot., datë 09.02.2018, që konfirmon kontratën e qirasë financiare ndërmjet kësaj shoqërie dhe znj. M. Q., për blerjen e automjetit tip “Volksëagen Polo”, sipas kontratës *** prot., datë 30.11.2010.

3.12.3 Shkësë nr. ***, datë 26.02.2018, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (referuar si “DPSHTRR”) ku, konfirmohet blerja e automjetit nëpërmjet qirasë financiare.

3.12.4 Deklarimet e subjektit, në pyetësorin standard të Komisionit të datës 12.02. 2018, përgjigjet e pyetësorit të datës 27.09.2018, përgjigjet e pyetësorit të datës 16.10.2018 dhe të datës 26.10.2018.

3.12.5 Deklarimet e subjektit mbi të ardhurat e tij dhe të familjarëve të tij, si dhe dokumentacionin¹⁰ për vërtetimin e të ardhurave.

3.12.6 Deklarimet e subjektit mbi të ardhurat e bashkëshortes dhe të prindërve të saj sipas

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin si vijon:

- Të ardhura nga paga si gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për periudhën 25.10.1993 - 31.12.2016, në vlerë 20.470.403 lekë.
- Të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës, si anëtar i Këshillit Drejtues për vitin 1999, në vlerë 16.200 lekë.
- Të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës si anëtar i Këshillit Drejtues për vitin 2000, në vlerë 12.150 lekë.
- Të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës si pedagog i jashtëm për vitin 2001, në vlerë 16.850 lekë.
- Të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës si anëtar i Këshillit Drejtues për vitin 2001, në vlerë 40.5016 lekë.
- Të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës si anëtar i Këshillit Drejtues për vitin 2001, në vlerë 16.200 lekë.
- Të ardhura nga paga si punonjës i Hetuesisë së Përgjithshme, për periudhën 03.06.1992 - 25.10.1993, nuk ka dokumentacion.
- Të ardhura nga paga si hetues në Hetuesinë (: Rrethit Tiranë, për periudhën 16.12.1986 - 03.06.1992, nuk ka dokumentacion (bashkëlidhur vërtetim negative, datë 24.01.2017).
- Të ardhura nga paga si hetues në Hetuesinë e Rrethit Gjirokastër, për periudhën qershor 1984 - 15.12.1986, nuk ka dokumentacion (bashkëlidhur kërkesa për marje të dhënash).
- Të ardhura nga paga si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjirokastër, për periudhën 31.3.1983 - 29.5. 1984, nuk ka dokumentacion (bashkëlidhur vërtetim negativ dt. 9.1 1.2016, nr. ***prot, të Gjykatës së Rrethit Gjirokastër).
- Të ardhura nga shitja e automjetit, tip “Volkswagen Polo”, sipas kontratës së shitjes së automjetit, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.892.016, në vlerë 900.000 lekë. (bashkëlidhur kontrata e shitjes).
- Të ardhura nga shitja e automjetit, tip “Mercedez - Benz”, sipas kontratës së shitjes, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.03.2013, në vlerë 5.000 lekë. (bashkëlidhur kontrata e shitjes).
- Të ardhura nga qiraja për apartamentin e ndodhur në, Rr. “****”, pll. ***, ap. ***, sipas kontratës së qirasë, nr. *** rep., nr. *** kol., në vlerë 45.000 lekë/muaj. (bashkëlidhur kontrata e qirasë si dhe fatura tatimore).
- Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë: me shkësën nr. ***prot., datë 03.08.2017, konfirmon se për shtetasin Fatos A. Qato, deri në periudhën 31.12.2014, nuk ka asnjë dokument apo shkësë zyrtare në lidhje me pagesat e kryera apo shlyelje detyrimi për zërin Tatim në Burim (tatim qeraje, tatim dividend, etj). Për periudhën 01.01.2015 e në vazhdim, z. Fatos Qato, sipas të dhënave të sistemit C@TS ka regjistruar si përgjegjësi Tatimin mbi Burim (Tatim qiraje), më datë 01.12.2016, ku bazuar në deklaratën e bërë në dhjetor 2016 është në shumë n 43.875 lekë. (Aneks nr. 36)
- Të ardhura nga pensioni i z. S. Sh. (babai i bashkëshortes së subjektit), me datë fillimi të pensionit 01.04.1991, në vlerë 49.265 lekë/muaj.
- Të ardhura nga pensioni i znj. V. Sh. (nëna e bashkëshortes së subjektit), me datë fillimi pensioni 01.08.1992, në vlerë 19.165 lekë/muaj.

pyetësorit standard të Komisionit të datës 12.02. 2018, deklarinimet e tij sipas pyetësorit të datës 27.09.2018, deklarinimet e tij sipas pyetësorit të datës 16.10.2018, deklarinimet e tij sipas pyetësorit të datës 26.10.2018, dhe përgjigjeve të rezultateve të hetimit të datës 06.12.2018.

3.12.7 Shkresën nr. * prot., datë 08.02.2018, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore** (referuar si “ISSH”), që ka konfirmuar të ardhurat financiare bruto dhe neto të realizuar nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja.

3.12.8 Shkresën nr. * prot., datë 09.02.2018, nga Qendra Kombëtare e Biznesit** (referuar si “QKB”), ku Komisioni është informuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk rezultojnë të regjistruar në regjistrin tregtarë.

3.13 Subjekti i rivlerësimit, me anë të shpjegimeve dhe provave të depozituar, më datë 06.12.2018, si dhe deklarinimeve në seancën dëgjimore ka argumentuar se:

3.13.1 Subjekti ka pretenduar që në analizën financiare t’i llogariten të ardhurat dhe shpenzimet e vjehrrit dhe të vjehrrës nga viti 1991 - 2016.

3.13.2 Subjekti gjithashtu ka pretenduar se, në vitet që rezultojnë me gjendje negative, teprica e çdo viti ushtrimor i është shtuar vitit pasues negativ dhe diferenca progresive është periodikisht pozitive që tregon se çdo vit ekzistojnë burime të mjaftueshme financiare për mbulimin e pasurisë dhe të shpenzimeve të kryera për çdo vit për periudhën 2003 - 2016.

3.13.3 Subjekti ka pretenduar se shpenzimet për arredimin e apartamentit duhet ti llogariten për një periudhë 26-vjeçare, nga 1990 - 2016.

3.13.4 Lidhur me mospagesën e tatimit të të ardhurave nga qiraja, subjekti ka parashtruar se nuk kishte pasur për qëllim fshehjen e këtyre të ardhurave, ndërsa mospagesa e tatimit mbi qiranë, gjithashtu nuk ka qenë e qëllimshme, pasi kishte ardhur si rezultat i mungesës së sensibilizimit të informacionit fiskal, 2007, 2012 dhe 2014.

3.14 Arsyetim ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm:

3.14.1 Lidhur me pamjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë dhe shpenzimeve të kryera me burimet financiare të deklaruara dhe dokumentuar, në total në vlerën 8.324.055 lekë, trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të ngritura në prapësimet e tij, pas kalimit të barrës provës, por edhe në seancën dëgjimore, vlerëson se:

3.14.2 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për shpërndarjen e shpenzimeve për arredimin, që ti llogariten për një periudhë 26-vjeçare, periudha 1990 - 2016, trupi gjykues çmon, se ky pretendim nuk merret në konsideratë, pasi Komisioni në përlllogaritjet financiare është bazuar në deklarinimet e vetë subjektit në pyetësorin standard, si dhe atë gjatë hetimit administrativ, që në mënyrë të analizuar argumenton:

✓ Pyetësori standard i Komisionit i referohet një periudhe të caktuar, për pesë vitet e fundit, për të cilën subjekti ka deklaruar se vlera e arredimit të banesës së tij ka kushtuar 25.000 euro.

3.14.3 Deklarimet e subjektit, janë kontradiktore, pasi gjatë hetimit administrativ ka deklaruar se arredimi i shtëpisë kishte filluar përpara vitit 2005, vit kur i është dhuruar banesa pasi kishin jetuar në atë shtëpi që nga momenti i ndërimit dhe regjistrimit që përkon me vitin **1995**, ndërkohë pas kalimit të barrës së provës dhe në seancën dëgjimore ndryshoi deklaram duke i kërkuar Komisionit që t’ia llogarisë nga **viti 1990**, pra deklaroi dy vite të ndryshme mbi fillimin e arredimit të banesës.

3.14.4 Gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të shpjegojë duke specifikuar saktësisht çdo vit vlerat përkatëse për arredimin e shtëpisë, dhe vetë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shpenzimet për arredim apo ndonjë kërkese bazë jetësore familjare kishin qenë kryesisht shumat e kursyera në vitin respektivë paraardhës. Në vijim ka deklaruar se nuk dispononte gjendje *cash* të lekëve pasi shumën e kursyer deri në 2011, e kishte përdorur një pjesë për arredimin e shtëpisë dhe pjesën tjetër i kishte përdorur për shpenzimet e viteve pasardhëse kryesisht për shkollimin e fëmijëve.

3.14.5 Në vlerësim të deklarimeve të subjektit, trupi gjykues çmon se ndryshimi i deklarimeve të subjektit mbi shpenzimet e arredimit janë përpjekje për të krijuar një rezultat pozitiv në bilancin e tij financiar, si dhe shpjegimet e tij nuk janë bindëse, për pasojë çmon se shpenzimet për arredimin të llogariten në bazë të deklarimit të tij gjatë hetimit administrativ dhe se ato janë realizuar me burimet e gjendjeve *cash* të deklaruara dhe shpenzuara vit pas viti.

3.14.6 Në lidhje me pretendimin e subjektit se në analizën financiare t’i llogariten të ardhurat dhe shpenzimet e vjehrrit dhe të vdjerrës nga viti 1991 - 2016, Komisioni, duke pasur në konsideratë se subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar këto të ardhura nga viti 2012 e në vijim, dokumentacionin e depozituar për të provuar të ardhurat e vjehrrit dhe vjehrrës, si dhe shpjegimet e tij, çmon se ato janë bindëse, për pasojë i mori në konsideratë duke kryer rillogaritje financiare të pasqyruara në tabelën nr. 6 si më poshtë vijon:

3.14.7 Trupi gjykues, në konsideratë të të ardhurave të vjehrrit dhe vjehrrës, administroi dokumentacionin provues të paraqitur nga subjekti:

- ✓ Vërtetim ISSH-së, nr. *** prot., datë 04.12.2018, mbi të ardhurat e realizuar në vite nga pensioni i znj. V. Sh., për periudhën 10.08.1992 - 30.11.2018, ku janë specifikuar shumat përkatëse për çdo vit;
- ✓ Vërtetim ISSH-së, nr. *** prot., datë 04.12.2018, mbi të ardhurat e realizuar në vite nga pensioni i z. S. Sh., për periudhën 01.04.1991 - 30.11.2018, ku janë specifikuar shumat përkatëse për çdo vit si dhe pensioni suplementar.

3.14.8 Në lidhje me mospagesën e tatimit të të ardhurave nga qiraja, trupi gjykues, sikurse ka konstatuar gjatë hetimit administrativ, se për këto të ardhura nuk ishte paguar tatimi, çmon se ato janë krijuar nga një aktivitet i ligjshëm siç është qiradhënia e një pasurie të paluajtshme, dhe nuk e ka mohuar faktin e deklarimit periodik të tyre nga subjekti, por në kushtet e mospagimit të tatimit,

këto të ardhura nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiare, pasi janë të ardhura të paligjshme në kuptim të nenit D, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Komisioni, arsyeton se është e pa pranueshme nga ana e një gjyqtari të Gjykatës së Apelit, një argumentim, se mungonte sensibilizimi mbi praktikën fiskale për pagimin e tatimit. Legjislacioni tatimor ka parashikuar qartë tatimin mbi të ardhurat nga qiraja dhe padijenja mbi këto praktika nuk e përjashton tatimpaguesin nga detyrimi apo aq më pak nga përgjegjësia.

Tabela 6 Analiza financiare, ndër vitet 2003-2016, duke përfshirë dhe të ardhurat e vjehrrit dhe vjehrrës

Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
1 PASURI	0	0	0	0	0	0	0	2 179 317	0	4 090 383	0	0	0	0	0
Shtepi banimi Rr ***	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Autoveturë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shtepi banimi dhurate nga vjehrra rr ***	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Autoveture Polo	0	0	0	0	0	0	0	2 179 317	0	0	0	0	0	0	0
Tokë are sip 410m2 *** Pogradec	0	0	0	0	0	0	0	0	0	108 363	0	0	0	0	0
Autoveturë Renault Koleos	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3 982 020	0	0	0	0	0
2 DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	1 108 526	-401 527	2 018 490	-771 373	-489 965	-569 458	-515 379	0
Leasing për blerje Volkswagen Polo Landeslease	0	0	0	0	0	0	0	1 108 526	-401 527	-390 247	-321 019	0	0	0	0
Leasing për blerje Renault Tirana Leasing.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2 408 736	-450 355	-489 965	-569 458	-515 379	0
3 PASURI NETO (1-2)	0	0	0	0	0	0	0	1 070 791	401 527	2 071 893	771 373	489 965	569 458	515 379	0
4 TË ARDHURA	1 426 762	1 846 058	1 928 884	2 252 893	2 152 409	1 866 606	1 966 865	2 230 173	2 136 874	3 822 629	4 925 264	3 309 857	3 325 351	4 442 652	0
Të ardhura subjekti	753 816	1 012 347	1 024 183	1 091 790	1 111 202	1 123 536	1 170 054	1 189 660	1 238 819	1 270 209	1 288 384	1 374 638	1 384 073	1 408 257	0
Të ardhura bashkëshortja	375 647	380 866	390 534	604 839	461 965	129 060	132 600	349 271	178 920	397 886	407 577	1 140 209	1 106 654	1 065 172	0
Të ardhura vjehri	190 841	331 340	375 796	406 085	421 574	444 994	478 434	497 192	517 361	537 553	555 574	572 244	582 810	590 749	6 502 547
Të ardhura vjehrra	106 458	121 505	138 371	150 179	157 668	169 016	185 777	194 050	201 774	209 501	216 390	222 766	226 814	229 849	2 530 118
Të ardhura nga qiraja Rr ***	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Të ardhura nga paga e vajzës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	150 000	0	0	0	0	0
Të ardhura nga vendimi gjyqësor nr *** dt 10.06.2008	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1 756 289	0	0	0	0
Të ardhura nga paga vajza e dyte	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	25 000	0	0
Të ardhura nga shitja e makinës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	701 050	0	0	900 000	0
Të ardhura nga shitja e Volkswagen Polo	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Dhurim nga vellezër dhe shokë për arsye shendetesore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1 257 480	0	0	0	0	0
Dhurim nga vjehrra për arredim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
5 SHPENZIME	891 986	883 216	1 421 906	1 864 930	1 825 844	1 910 919	1 956 443	1 926 865	2 097 958	4 012 284	2 547 618	4 194 273	2 506 199	3 426 516	0
Interesa leasing Landeslease	0	0	0	0	0	0	0	7 011	94 739	92 078	75 744	0	0	0	0
Interesa leasing Tirana Leasing	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	222 653	238 607	61 943	76 698	0
shpenzime ILDKPKI	594 657	594 657	726 803	726 803	726 803	817 905	817 905	817 905	817 905	817 905	817 905	625 598	695 778	517 627	0
shpenzime jetese vjehri vjehrra	297 329	237 863	290 721	290 721	290 721	327 162	327 162	327 162	327 162	327 162	327 162	312 799	347 889	258 814	-4 289 829
Shpenzime mjeksore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1 257 480	0	0	0	0	0
Shpenzime arredimi financiar nga vjehrra	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	676 350	0
Shpenzime udhëtimi sipas TIMS dhe pyetësorit	0	50 696	404 382	247 406	308 321	365 852	311 376	305 382	457 773	808 979	694 040	645 907	550 600	673 645	0
Shpenzime shkollimi dhe jetese në Hollandë vajza madhe	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1 821 430	412 950	0	0
Shpenzime shkollimi dhe jetese në Hollandë vajza vogël	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	966 369	0
Shpenzime arredimi sipas pyetësorit dt *** 25.000 euro.	0	0	0	600 000	500 000	400 000	500 000	400 000	0	300 000	0	0	0	0	0
Shpenzime shkollimi djali	0	0	0	0	0	0	0	69 405	400 379	408 681	410 114	549 932	437 039	257 013	0
6 LIKUIDITETE NË FILLIM TË VITIT	0	0	634 779	557 470	1 015 076	1 327 062	1 257 915	875 473	1 262 920	1 172 778	1 068 143	1 186 508	1 169 679	1 105 742	0
Credins Bank M. Q. 230382	lekë	0	0	0	0	0	0	0	0	2 970	7 290	7 290	7 290	7 290	0
Credins Bank Fatos Qato 81494	lekë	0	0	0	0	0	74 107	8 260	1 464	57 256	22 277	3 818	9 302	35 025	0
Raiffeisen Bank Fatos Qato 854160	lekë	0	0	8 393	12 251	3 096	40	40	40	40	40	40	40	40	0
Raiffeisen Bank M. Q. 024579	lekë	0	0	26 386	45 218	7 736	14 248	40 171	24 334	18 956	27 938	143 026	206 839	152 132	0
Union Bank M. Q. 111296568060114	lekë	0	0	0	0	0	0	42 360	24 540	56 595	65 920	23 796	7 927	7 630	0
Union Bank K. Q. 119416975060112	lekë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	26 343	0
Intesa M. Q. 455019	lekë	0	0	0	0	-306	81 257	18 907	32 298	-1 879	-7 621	0	0	0	0
Intesa M. Q. 455019	euro	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	3	503	462	0
Intesa M. Q. 455019	euro	0	0	0	0	0	148	113	155	262	1 691	337	219	271	0
Intesa M. Q. 455019	euro	0	0	0	0	5 000	5 189	5 341	5 556	5 732	5 871	6 009	6 095	6 105	0
CASH	lekë	0	0	600 000	500 000	400 000	500 000	400 000	0	300 000	0	0	0	0	0
7 LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT	0	0	634 779	557 470	1 015 076	1 327 062	1 257 915	875 473	1 262 920	1 172 778	1 068 143	1 186 508	1 169 679	1 105 742	0
Credins Bank M. Q. 230382	lekë	0	0	0	0	0	0	0	0	2 970	7 290	7 290	7 290	7 290	0
Credins Bank Fatos Qato 81494	lekë	0	0	0	0	0	74 107	8 260	1 464	57 256	22 277	3 818	9 302	35 025	3 673
Raiffeisen Bank Fatos Qato 854160	lekë	0	0	8 393	12 251	3 096	40	40	40	40	40	40	40	40	0
Raiffeisen Bank M. Q. 024579	lekë	0	0	26 386	45 218	7 736	14 248	40 171	24 334	18 956	27 938	143 026	206 839	152 132	116 535
Union Bank M. Q. 111296568060114	lekë	0	0	0	0	0	0	42 360	24 540	56 595	65 920	23 796	7 927	7 630	7 647
Union Bank K. Q. 119416975060112	lekë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	26 343	0
Intesa M. Q. 455019	lekë	0	0	0	0	-306	81 257	18 907	32 298	-1 879	-7 621	0	0	0	0
Intesa M. Q. 455019	euro	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	3	503	462	12
Intesa M. Q. 455019	euro	0	0	0	0	0	148	113	155	262	1 691	337	219	271	1 055
Intesa M. Q. 455019	euro	0	0	0	0	5 000	5 189	5 341	5 556	5 732	5 871	6 009	6 095	6 105	6 108
CASH	lekë	0	0	600 000	500 000	400 000	500 000	400 000	0	300 000	0	0	0	0	0
DIFERENCA (TË ARDHURA - PASURI-SHPENZIME 4+6-3-5-7)	534 776	962 842	-127 801	465 273	-131 042	-356 299	79 570	-385 041	-750 058	-2 171 407	1 710 908	-1 492 745	266 524	564 694	-829 807
															-5 414 393

3.14.9 Në lidhje me shumën prej 5.000 eurosh, të pretenduara nga subjekti si shpenzim i kryer nga vjehrra dhe vjehrrit për blerjen e këndit, Komisioni, në konsideratë të të ardhurave të prindërve të bashkëshortes së subjektit, në analizën e financiare, të ripërlllogaritur, këtë shumë e konsideroi gjithashtu si shpenzim të familjes, si pasojë e bashkëjetesës së përbashkët me vjehrrin e vjehrrën.

3.14.10 Nga përlllogaritjet e kryera edhe në konsideratë të të ardhurave të vjehrrës e vjehrrit, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka të ardhura të mjaftueshme për të investuar në blerjen e pasurive dhe për të përballuar shpenzimet e kryera, për vitet 2005, 2007, 2008, 2010, 2011, 2012, 2014, në vlerën **-5.414.393 lekë**.

3.14.11 Lidhur me pretendimin e subjektit, se në vitet që rezultojnë me gjendje negative, teprica e çdo viti ushtrimor ti shtohet vitit pasues negativ dhe diferenca progresive është periodikisht pozitive, çka tregon se çdo vit ekzistojnë burime të mjaftueshme financiare, trupi gjykues, çmon se në analizë të deklaramëve periodike të subjektit por edhe të deklaramëve të tij gjatë hetimit administrativ, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar sikurse ka pasur detyrim ligjor, shtesat e pakësimit e likuiditeteve, nuk rezultoi t'i ketë deklaruar këto të ardhura si gjendje likuiditeti *cash*, në fund të çdo viti, fakt ky i pranuar nga subjekti edhe në seancë dëgjimore.¹¹ Për pasojë pretendimi i subjektit nuk mund të merret në konsideratë. Edhe në këtë drejtim trupi gjykues e çmon, këtë pretendim si përpjekje të subjektit për të rregulluar situatën e tij financiare, dhe shpjegimet e tij nuk janë bindëse.

3.14.12 Në përfundim, trupit gjykues, pas rillogaritjeve të kryera në konsideratë të të ardhurave të vjehrrës dhe vjehrrit, i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar pasuritë, si dhe për të mbuluar shpenzimet e tij dhe të familjes ndër vite¹². Pasi u morën në konsideratë pretendimet e subjektit, nga përlllogaritjet e kryera rezultoi se subjekti i rivlerësimit, ka gjendje negative për vitet:

✚ **Vitin 2005 në vlerën -127,801 lekë, vitin 2007 në vlerën -131,042 lekë, vitin 2008 në vlerën -356,299 lekë, vitin 2010 në vlerën -385,041 lekë, vitin 2011 në vlerën – 750,058 lekë, vitin 2012 në vlerën -2.171,407 lekë, vitin 2014 në vlerën -1.492,745 lekë**

Baza Ligjore

Bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, deklaramet e subjektit gjatë hetimit dhe shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues, arrin në përfundimin se:

- ✓ Referuar rezultateve të hetimi administrativ kryesisht, subjekti i rivlerësimit, duket se nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet ndër vite, për këtë fakt atij i kaloi barra e provës për të justifikuar pamjaftueshmërinë e të ardhurave, nga ku edhe duke përfshirë të ardhurat e vjehrrit dhe vjehrrës e sipas provave të subjektit, rezultoi se subjekti nuk ka të ardhura të mjaftueshme për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve ndër vite. Subjekti

¹¹ Refero procesverbalin e seancës dëgjimore “subjekti përmes përfaqësuesit të tij deklaroi “...Komisioni nuk i konsideroi të ardhurat për periudhë n 1998 - 2002, ato janë të ardhura që vërtet nuk janë deklaruar, por kanë ekzistuar”.....

¹² Vitet me gjendje negative rezultuan, 2005,2007,2008,2010,2011,2012,2014.

i rivlerësimit ka bërë deklarin të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë referuar paragrafit 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

- ✓ Trupi gjykues arrin në këtë përfundim, pasi i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit shpenzimet e kryera kryesisht për shkollimin e fëmijëve si dhe ato të kurimit, arredimit, nuk i ka deklaruar as në deklaratën “Vetting” apo ato periodike, **që në mënyrë të plotë mbi faktet e rrethanat për këto shpenzime arsyeton si më poshtë:**

3.15. Mbi shpenzimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në pyetësonin standard të përlllogaritura në analizën financiare ndër vite 2003 - 2016, tabela nr. 4 - 5.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

3.15.1 Në përgjigjet e pyetësonit standard të Komisionit, më datës 12.02.2018, subjekti ka deklaruar shpenzimet si më poshtë referuar:

- ✓ Shpenzime shëndeti për z. Fatos Qato në “Spitalin ***”, në qershor të vitit 2012. Ndërhyrje koronare me vlerë mbi 2.500 euro;
- ✓ Shpenzime shëndeti për z. Fatos Qato, në spitalin “***”, në korrik 2012. Ndërhyrje koronare me vlerë rreth 6.500 euro, financim i ndihmuar nga vëllezërit dhe shoqëria;
- ✓ Shpenzime për blerje makine me këste, në shtator 2012, deklaruar në formularin e vetëdeklarimit;
- ✓ Shpenzime për blerje këndi divani në shtator 2016 me vlerë 5.000 euro financuar nga prindërit e bashkëshortes që bashkëjetojnë me subjektin.

3.15.2 Për shpenzimet 6.500 euro të kurimit dhe shpenzimet 5.000 euro të blerjes së këndit, Komisioni i ka kërkuar subjektin të japë shpjegime nëse i ka kthyer këto financime, të identifikojë personat që kanë financuar si dhe depozitujë dokumentacion ligjor provues për shumën e parave të dhëna nga vëllezërit dhe shoqëria si dhe për shumën e dhëna nga prindërit e bashkëshortes.

3.15.3 Në vijim, në përgjigjet e pyetësonit të datës 27.09.2018, subjekti ka deklaruar se: “Shpenzimet mjekësore kishin qenë ndihmesa nga vëllezërit të tij, nga djali i xhaxhait me iniciale A. Q, dhe nga shoqëria, gjithashtu nuk posedonte dokumente ligjore, pasi këto shuma i ishin dhënë në **cash** e jo nëpërmjet ndonjë transaksioni bankar. Gjithashtu pjesë të tjera të shumës afërsisht jo më shumë se 3.000 euro kanë qenë ndihma financiare të dhëna në momentin e ardhjes për vizitë familjare nga të afërmit dhe shoqëria (me vlera jo më shumë se 100 euro cili).

3.15.4 Për sa i përket pagesës për blerjen e këndit, ajo ishte bërë me kursimet e prindërve të bashkëshortes, të cilët janë bashkëjetues dhe në këto kushte nuk ishte detyrim financiar ndaj tyre pasi ishte një kontribut në natyrë të tyre në ambientet që i përdornin bashkërisht”.

3.15.5 Lidhur me depozitimimin e dokumentacionit mbi burimin e ligjshëm të tyre si dhe në përgjigje të kërkesës së Komisionit që personat dhurues të konfirmonin këto dhurime, për kurimin e subjektit

në Gjermani, ai depozitoi tre deklarata noteriale¹³, përmes së cilave konstatohet se deklaruesit deklarojnë se i kanë dhënë subjektit shumat nga 500 euro, duke argumentuar se burimi i këtyre shumave janë nga të ardhurat e tyre nga puna, por nuk kanë bashkëlidhur asnjë dokument që të provonin ligjshmërinë e burimit të tyre. “Për sa i përket dhurimit të shumës 2.000 euro të dhënë nga vëllai i tij shtetasi I. Q., subjekti ka deklaruar se nuk mund të siguronte dokumentacion ligjor pasi ai ka ndërruar jetë në vitin 2016, dhe lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të tij, ka sqaruar se vëllai i tij ka punuar dhe jetuar në Athinë familjarisht për më shumë se 20 vjet”.

3.15.6 Në lidhje me shumën e dhënë nga prindërit e bashkëshortes, në vlerën 5.000 euro, subjekti gjatë hetimit administrativ, nuk depozitoi dokumentacion për të provuar dhënien e këtyre shumave si dhe të provonte burimin e ligjshëm të të ardhurave të krijuara nga prindërit e bashkëshortes.

3.15.7 Nga analiza e fakteve të sipërpërmendura, Komisionit i rezultoi e për pasojë i kaloi barrën e provës subjektit, pasi vërehej se subjekti nuk kishte deklaruar në deklaratat periodike (2012) si dhe në deklaratën “Vetting” shumat e shpenzuara në vlerën 6.500 euro për kurimin e tij në Gjermani, si dhe nuk kishte deklaruar në deklaratat periodike (2016) si dhe në deklaratën “Vetting” shpenzimet për blerjen e këndit në vlerën 5.000 euro si dhe nuk provoi me dokumentacion burimet e ligjshme të përdorura.

3.16 Subjekti i rivlerësimit, me anë të shpjegimeve dhe provave të depozitua, më datë 06.12.2018, si dhe deklarimeve në seancën dëgjimore ka parashtruar se:

3.16.1 Subjekti pretendoi se shpenzimet e cituara si të padeklaruara prej tij, janë konsideruar si shpenzime jetike, ndërkohë që edhe formulari në deklaratat periodike si dhe formulari në deklaratën “Vetting” nuk e ka të specifikuar nëse këto shpenzime duhet të pasqyroheshin në deklaratën përkatëse.

3.16.2. Arsyetim ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm:

a) Lidhur me mosdeklarimin e shpenzimeve në deklaratën “Vetting” dhe në deklaratën periodike, trupi gjykues, çmon se deklarimi i tyre ka qenë një detyrim ligjor në deklaratën periodike për t’u përmbushur pasi:

3.16.3 Në formularin e DVP, të vitit 2012, ku nuk janë deklaruar shpenzime për kurim, është parashikuar: “Përshkruani hollësisht çdo lloj shpenzimi i deklarueshëm, me vlerë mbi 500.000 lekë, si për arsim, mjekim shëndetësor, pushime, arredim e të tjera të këtij lloji, të kryera nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit”. Në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, është parashikuar se: *“Shpenzim i deklarueshëm është tërësia monetare, e paguar për arsim, mjekim shëndetësor, pushime, arredim, si dhe të tjera shpenzime të*

¹³ Nr. *** rep., dhe nr. *** ko.l, datë 15.10.2018, lëshuar nga z. P. Q.; - nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 15.10.2018, lëshuar nga z. A. Q.; - nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 15.10.2018, lëshuar nga z. H. B.

këtij lloji, të kryera nga subjekti deklarues. Më tej në nenin 4, 1, është parashikuar se: “Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: h) çdo shpenzim i deklarueshëm, me vlerë mbi 500.000 (pesëqind mijë) lekë, i kryer gjatë vitit të deklarimit”.

Pra, sa referuar në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, rezulton se deri në vitin 2012, ka qenë detyrim i deklarimit të shpenzimeve, me vlerë mbi 500.000 lekë, pas vitit 2012 me ndryshimet që pësoi ky ligj, vlera e shpenzimeve të detyrueshme për deklarim është ulur në shumën 300.000 lekë.

Trupi gjykues bazuar në parashikimet ligjore të sipërcituara, dhe formularët deklarues çmon se ka qenë detyrim ligjor deklarimi me saktësi i shpenzimeve të kurimit, në vlerën 6.500 euro.

Në lidhje me pretendimin e subjektit se shpenzimet e padeklaruara prej tij janë konsideruar nga ana e subjektit si shpenzime jetike, dhe se ndërkohë që edhe formulari në deklaratat periodike si dhe formulari i deklaratës “Vetting” nuk e ka të specifikuar apo të shpjeguar nëse këto shpenzime duhet të pasqyroheshin në deklaratën përkatëse, trupi gjykues vlerëson se, në ligjin nr. 9049/2003, i ndryshuar, është parashikuar qartazi, detyrimi ligjor i deklarimit të shpenzimeve, në këto kushte çmon se mbrojtja për mosnjohje të ligjit, apo azhurnimit të tij, nuk i ofrohet asnjë shtetasi në Republikën e Shqipërisë, aq më pak një shtetasi me njohuri të posaçme në fushën përkatëse, siç është gjyqtari i Gjykatës së Apelit.

Baza Ligjore

Bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, deklarimet e subjektit gjatë hetimit dhe shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

Trupi gjykues vlerëson se, deklarimi i shpenzimeve të kurimit në deklaratën periodike të vitit 2012, ka qënë detyrim ligjor, dhe subjekti i rivlerësimit për këtë vit, duket se nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për t'i përballuar këto shpenzime. Subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar saktë deklaratën vjetore të vitit 2012, pasi nuk ka deklaruar shpenzimet e kurimit, si dhe nuk ka pasur burime të mjaftueshme për krijimin e tyre, kjo në kundërshtim me gërmen a) e b) të nenit 33 të ligjit nr.84/2016. Mosdeklarimi i shpenzimeve në deklaratën periodike të pasurisë, ka ardhur si pasojë e mungesës së të ardhurave të ligjshme, për rrjedhojë edhe deklarimi i të ardhurave në deklaratën vetting, nuk është i saktë.

Trupi gjykues arrin në këtë përfundim bazuar edhe në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se “*Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit*”. Në interpretim të dispozitave të mësipërme, qëllimi dhe fryma e Kushtetutës dhe ligjit është e tillë që nga ky proces i rivlerësimit të verifikohen dhe të gjithë ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht apo plotësisht pasuritë e tyre.

- ✓ **Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, sipas nenit 61 pika 3, e ligjit nr.84/2016, i cili referon nenin 33 të po këtij ligji.**

3.17 Shpenzimet për shkollimin e fëmijëve.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

3.17.1 Me pyetësin e datës 21.09.2018, subjekti ka deklaruar¹⁴ shpenzimet financiare të shkollimit të tre fëmijëve dhe të shpenzimeve të tyre të jetës jashtë vendit.

Mbi shpenzimet e shkollimit dhe jetesës së vajzës së subjekti, znj. E. Q., në Holandë.

3.17.2 Në përgjigjet e pyetësit të datës 27.09.2018, për shkollimin e vajzës, znj. E. Q., subjekti i rivlerësimi ka deklaruar se, vajza e tij, kishte kryer fillimisht studimet në shkollë publike, e për rrjedhojë nuk kishte krye shpenzime për përfundimin e ciklit universitar në vitin 2012.

3.17.3 Në vitin 2014 ka filluar studimet për master në “University of ***”, The Netherlands, Master Business Information System, nga shtatori i këtij viti, duke deklaruar shpenzimet si më poshtë:

a) Shpenzime të kostos së shkollimit në vlerën 12.000 euro, duke e shoqëruar më një vërtetim të lëshuar nga “Universiteti of ***, The Netherlands”.

b) Shpenzime jetese në vlerën 1.000 euro, nga shtatori i 2014 deri në dhjetor të 2014.

c) Në vijim ka deklaruar se vajza e tij, e kishte rezidencën e banimit te shtëpia e shokut të saj, z. A. SH., i cili ishte rezident kohë më parë në Holandë, duke bashkëlidhur kontratën e qirasë në emër të përdoruesve të banesës. (Vajza e subjektit, për efekt adresari figuron si banuese në këtë adresë dhe shpenzimet e akomodimit të saj i mbuloheshin më parë dhe më pas nga rezidenti A. Sh).

3.17.4 Në vitin 2015, ka deklaruar shpenzime jetese nga janari deri në gusht, **po në vlerën 1.000 euro**, ndërsa nga gushti i vitit 2015, kohë kur ka mbaruar studimet dhe deri më sot është në marrëdhënie pune dhe vetëfinancohet për çdo nevojë jetese.

3.17.5 Subjekti i rivlerësimit, pas kërkesës së Komisionit, me pyetësin e datës 10.10.2018, që të deklaronte nëse shpenzimet e jetesës në vlerën 1.000 euro, ishin për çdo muaj, apo për secilën periudhë nga 1.000 euro, në total 2.000 euro, subjekti ka shpjeguar se:

- ✓ Për vitin 2014 nga muaji shtator - dhjetor shpenzimet e jetesës ishin në vlerën 1.000 euro.
- ✓ Për vitin 2015 shpenzimet e jetesës kanë qenë 3.000 euro (1000 euro në dy muaj) për periudhën 6 muaj pasi në muajin gusht vajza paralelisht me studimet ka filluar dhe marrëdhënie pune.

3.17.6 Në çmuarje të dy deklarimeve mbi shpenzimet e jetesës së vajzës së subjektit, E. Q., Komisioni, konstatoi se ky deklarim i subjektit binte në kundërshtim me deklarimin e tij, më datë

¹⁴ si dhe i është kërkuar që të depozitohë dokumentacion justifikues si faturat e shkollës si dhe kontratat e qirasë së rezidencës.

27.09.2018, ku subjekti ndër të tjera deklaroi se shpenzimet e jetesës për vajzën e tij, E. Q., për periudhën nga janari - gusht 2015, kishin qenë 1.000 euro.

Mbi shpenzimet e shkollimit dhe jetesës së vajzës së subjektit, K. Q., në Holandë.

3.18 Në përgjigjet e pyetësorit të datës 27.09.2018, për shkollimin e vajzës së tij, K. Q., subjekti ka deklaruar se, vajza e tij, kishte kryer fillimisht studimet në shkollë publike, e për rrjedhojë nuk kishte krye shpenzime për përfundimin e ciklit universitar në vitin 2015.

3.18.1 Në vitin 2016 ka filluar studimet për master në “University of ***, The Netherlands”, Master Computer Science and Science Baged Business, duke deklaruar shpenzimet si më poshtë:

a) Shpenzime të kostos së shkollimit për vitin e parë në shumën 7.000 euro. Pagesat ishin kryer me këste, kësti i parë paguar në shtator, në shumën 3.500 euro dhe kësti i dytë paguar në nëntor në shumën 3.500 euro. Shpenzime jetese nuk kishte pasur pasi është e financuar dhe ka jetuar në banesën e motrës E. Q.

b) Në vitin 2017, shpenzime të kostos së shkollimit në shumën 10.500 euro, pjesë për vitin e parë të masterit e financuar nga prindërit. Pagesa është bërë me këste. Për vitin e dytë të masterit për shumën 7.000 euro, financuar nga e motra E. Q. Pagesa është bërë me këste, në shumën 3.500 euro në shtator dhe në shumën 3.500 euro në nëntor. Shpenzime jetese nuk ka pasur pasi kishte jetuar dhe jeton te motra E. Q.

Mbi shpenzimet e shkollimit dhe jetesës së djalit të subjektit, E. Q.

3.19 Në përgjigjet e pyetësorit të datës 27.09.2018, për shkollimin e djalit të tij, E. Q., ka deklaruar, shpenzime të shkollimit në shkollën private "****" Tiranë, për vitet 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, 2017, **në shumën 3.000 euro në vit**, duke përfshirë dhe transportin dhe uniformën.

3.20 Komisioni, kreu analizën financiare për vitet 2014 dhe 2015, sipas tabelës nr. 5 të pasqyruar më lartë, nga ku konstatoi se subjekti i rivlerësimit, bazuar te dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe deklaratimet e tij, për vitin 2014, dhe 2015, kishte mungesë të burimeve financiare, për të kryer shpenzimet e shkollimit të fëmijëve.

3.20.1 Nga analiza e fakteve të sipërpërmendura, Komisionit i rezultoi, dhe për pasojë i kaloi barrën e provës subjektit, se: a) vërehej se subjekti nuk kishte deklaruar në deklaratat periodike (2014 dhe 2015) si dhe në deklaratën “Vetting” shpenzimet e realizuara për shkollimin e fëmijëve në Holandë, për vitet 2014, 2015 dhe 2016; b) bazuar në deklaratimet e tij, vërehej se për vitin 2014, kishte mungesë të burimeve financiare, në shumën prej 1.974.956¹⁵ lekësh, ndërsa për vitin 2015 kishte mungesë të burimeve financiare në shumën prej 195.211 lekësh¹⁶.

3.21 Subjekti i rivlerësimit, me anë të shpjegimeve dhe provave të depozituar, më datë 06.12.2018, si dhe deklaratimeve në seancën dëgjimore parashtroi:

3.22 Subjekti ka pretenduar se, shpenzimet e cituara si të padeklaruara prej tij për shpenzimet e shkollimit janë konsideruar si shpenzime jetike, ndërkohë që edhe formulari në deklaratat periodike dhe si dhe formulari në deklaratën “Vetting”, nuk e ka të specifikuar apo të shpjeguar nëse këto shpenzime duhet të pasqyrohen në deklaratën përkatëse.

3.23 Subjekti ka pretenduar se nuk kishte pasur si qëllim që t'i fshehte këto shpenzime, pasi që në

¹⁵ Referojuni tabelës, nr. 5.

¹⁶ Referojuni tabelës, nr. 5.

momentin e parë që ishte pyetur, i kishte deklaruar vullnetarisht këto shpenzime.

3.24 Arsyetim ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm:

a) Lidhur me mosdeklarimin e shpenzimeve të shkollimit të fëmijëve, në deklaratën “Vetting” dhe në deklaratën periodike, trupi gjykues çmon se deklarimi i tyre ka qenë një detyrim ligjor për t’u përmbushur pasi:

3.24.1 Në formularin e DVP, të vitit 2014, është përcaktuar: *“Përshkruani hollësisht çdo lloj shpenzimi i deklarueshëm me vlerë mbi 300.000 lekë, si për arsim, mjekim shëndetësor, pushime, arredim e të tjera të këtij lloji të kryera nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit”*. Në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, me ndryshimet e ligjit të vitit 2012, është parashikuar se: “Shpenzim i deklarueshëm është tërësia monetare, e paguar për arsim, mjekim shëndetësor, pushime, arredim, si dhe të tjera shpenzime të këtij lloji, të kryera nga subjekti deklarues”*.

3.24.2 Më tej në nenin 4.1, është parashikuar se: *“Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: “.... h) çdo shpenzim i deklarueshëm, me vlerë mbi 300.000 (treqind mijë) lekë, i kryer gjatë vitit të deklarimit”*.

3.25 Për rrjedhojë lidhur me mosdeklarimin e shpenzimeve të shkollimit në deklaratën periodike, trupi gjykues çmon se deklarimi i tyre ka qenë një detyrim ligjor për t’u përmbushur.

3.26 Në vijim, trupi gjykues, lidhur me pretendimin e subjektit se shpenzimet e jetesës së vajzës së të tij në Holandë, ishin bërë nga shtetasi A. Sh., në vlerësim të dokumentacionit të depozituar, si kontratë qiraje, kontratë punësimi të këtij shtetasi, dokumenti nga sigurimet shoqërore, datë 11.10.2018, *(përkthyer dhe noterizuar)*, tregojnë se ky shtetas ka pasur të ardhura të ligjshme punësimi, për të provuar mundësitë e tij financiare për të mbuluar këto shpenzime.

Trupi gjykues në analizën financiare të subjektit, edhe pasi pranoi pretendimin e subjektit, se shpenzimet e jetesës ishin mbuluar nga ky shtetas, duke përfshirë në përlllogaritje të ardhurat e vjehrrit e vjehrrës, vëren se:

Deklarimi i shpenzimeve të shkollimit të fëmijëve në deklaratën periodike të vitit 2014, ka qenë detyrim ligjor dhe subjekti i rivlerësimit për këtë vit, duket se nuk ka patur të ardhura të mjaftueshme për të kryer shpenzimet e shkollimit të fëmijëve të tij, në vitin 2014, në shumën minus -1.492.745 lekë, pasqyruar në tabelën nr. 6. Mosdeklarimi i shpenzimeve në deklaratën periodike të pasurisë, ka ardhur si pasojë e mungesës së të ardhurave të ligjshme, për rrjedhojë edhe deklarimi i të ardhurave në deklaratën vetting, nuk është i saktë.

Trupi gjykues arrin në këtë përfundim bazuar edhe në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se *“Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit”*. Në interpretim të dispozitave të mësipërme, qëllimi dhe fryma e Kushtetutës dhe ligjit është e tillë që nga ky proces i rivlerësimit të verifikohen dhe të gjithë ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht apo plotësisht pasuritë e tyre.

- ✓ **Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, sipas nenit 61 pika 3, e ligjit nr.84/2016, i cili referon nenin 33 të po këtij ligji.**

V. VLERËSIMI FINAL I ÇËSHTJES

ARSYETIMI LIGJOR DHE ANALIZA E ASETVE DHE TË ARDHURAVE SË BASHKU

Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e Pasurisë për Procesin e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting 2017”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; (iv) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike; (v) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim që të kuptohet më qartë raporti midis asetve të deklaruara dhe të ardhurave të ligjshme, si dhe analiza financiare e kryer, konkludon se subjekti i rivlerësimit:

- **Nuk ka deklaruar saktë dhe në mënyrë konsistente pagesën e këstit të katërt mbi çmimin e blerjes së apartamentit, me sipërfaqe 141 m², si dhe vlerëson se:**
 - ✓ shpjegimet e tij për justifikimin e pagesave për këstet, nuk janë bindëse, pasi subjekti nuk ka përllogaritur/përfshirë shpenzimet jetike të familjes në bashkëjetesë me prindërit e bashkëshortes;
 - ✓ subjekti është në pamundësi financiare, që me të ardhurat e realizuara sipas pretendimeve të tij, të paguajë këstet për blerjen e apartamentit, dhe të përballojë shpenzimet e jetesës të familjes me disa antarë.
- **Nuk ka deklaruar në deklaratat periodike shpenzimet e arredimit, kurimit të tij shëndetësor, shkollimit të fëmijëve.**
- **Mosdeklarimi i shpenzimeve në deklaratat periodike të pasurisë, ka ardhur si pasojë e mungesës së të ardhurave të ligjshme ndër vite dhe për rrjedhojë edhe deklarimi i të ardhurave në deklaratën vetting, nuk është i saktë.**
- **Subjekti ka mungesë të burimeve financiare, ndër vite, në vlerën -5.414.393 lekë, për të justifikuar blerjen pasurisë, tokë arë, për blerjen e automjetit, tip “Volswagen Polo”, blerjen e automjetit, tip “Renault”, si dhe për të përballuar shpenzime mjekësore, arredimit, shkollimit të fëmijëve, të udhëtimit, si dhe shpenzimet jetike të familjes së tij.**
- **Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe nuk ka dhënë shpjegime bindëse, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, referuar pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.**

Në përfundim të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Fatos Qato, vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar analizës së sipërcituar për pasuritë të ardhurat dhe shpenzimet e kryera veç e veç, si dhe të marra së bashku, çmon se, subjektit të rivlerësimit, z. Fatos Qato, nuk arriti një nivel të besueshëm lidhur me kriterin e pasurisë.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenet 179/b, D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe në nenin 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Fatos Qato, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 17.12.2018.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Valbona Sanxhaktari
Kryesues

Brunilda Bekteshi
Relatore

Suela Zhegu
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Fiorela Mandro

